**DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR**

**PROCEDURËN E HAPUR E THJESHTUAR**

**SHËRBIME[1][2]**

**OBJEKTI:**

**“SHPENZIME PËR QIRAMARRJE APARATE DHE PAISJE TEKNIKE, MAKINERI”**

**TIRANË**

**2026**

---

[1] **Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash autoriteti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.**

[2] **Seti i Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë hartohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet variantit të setit në gjuhën shqipe me variantin në gjuhën angleze, do të merret për bazë seti në gjuhën shqipe.**

**NJOFTIME**

**NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT**
*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor nese aplikohet )*

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**;

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

1.2 **Lloji i Autoritetit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Institucion qendror | Institucioni i pavarur |
| □ | □ |
| Njësi e autoriteteve vendore | Të tjera |
| □ | □ |

1.3 **Kategoria e Autoritetit Kontraktor:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Autoritet kontraktor që prokuron për nevoja të veta | Organ Qendror blerës | Ofrues shërbimi | |
| | | Publik | Privat |
| □ | □ | □ | □ |
| I deleguar | Të tjera | | |
| □ | □ | | |

**1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit**:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: ______________________________________________
Tel/faks ______________________________________________
E-mail ______________________________________________

**1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**

______________________________________

**1.6 Lloji i procedurës së prokurimit:** ____________________________

**1.7 Tipi i kontratës**:______________________________________________

**1.8 Fondi limit i përllogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përllogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit Kontraktor**

(*në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjeçare*) :
______________________________________________________________________

**1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër :**_________________________________

**1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:**
______________________________________________________________________________________

**1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:**
________________________________________________________________________

**1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:**
___________________________________________________________________

**1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti kontraktor:**__________________________________________________________________________
__________________________________________________________________

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**NJOFTIMI I KONTRATËS**

**Seksioni 1: Autoriteti Kontraktor**

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

| | |
|---|---|
| Emri: | Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit |
| Adresa: | Rruga "Bilal Golemi", Godina nr. 29, Tiranë, Shqipëri |
| Tel/Faks: | |
| E-mail: | prokurimetapr@gmail.com |
| Adresa e ueb-faqes: | www.aprtirana.al |
| Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail) | *Odeta Mersini* |

**1.2 Lloji i Autoritetit Kontraktor:**

Institucion qendror ☐

Institucioni i pavarur ☐

Njësi e autoriteteve vendore X

Të tjera ☐

**1.3 Kategoria e Autoritetit Kontraktor:**

Autoritet kontraktor që prokuron për nevoja të veta X

Organ Qendror blerës ☐

Ofrues Shërbimi: Publik ☐ Privat ☐

I deleguar ☐

Të tjera ☐

**1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**1.5 Kontrate që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**1.6 Kontratë e rezervuar :**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**Seksioni 2: Objekti i Kontratës:** ***"Shpenzime për qiramarrje aparate dhe paisje teknike, makineri"***

**2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) : REF 99665-09-14-2026**

**2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP**

**Projektor 30191200-6,**

**Projektor per video 38652120-7,**

**Karrige 39112000-0**

**2.3 Lloji i "Kontratës Publike për shërbime"**

**2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:**

Po X Jo ☐

**2. 5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:**

**Me një Operator Ekonomik** **X**

**Me disa Operatorë Ekonomikë** ☐

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** Po **X** Jo ☐

**2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

| |
|---|
| Në zbatim të nenit 52/3 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", në nenin 61 (Qëllimi) si dhe neni në nenin 64 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), përcaktohet se: "Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen dhe nuk ka siguri për kohën e dorëzimeve/realizimeve e të ekzekutimit të kontratave".<br><br>Në rastin konkret kërkesa e mësipërme për prokurim është sherbim i vazhdueshëm dhe nisur nga natyra e tij, është e pamundur të parashikohen me saktësi numri i nevojshme i aktiviteteve që mund të realizohen gjatë gjithë periudhës së kërkuar.<br><br>Në nenin 64 pika a të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, ku përcaktohet se: "Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk |

| |
|---|
| mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër”.<br><br>Referuar objektit të prokurimit, aktivitete të vazhdueshme, për arsye teknike dhe organizative, shërbimi nga OE të ndryshëm nuk është i favorshëm.<br><br>Kjo procedurë po përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, pasi të gjitha kushtet janë të përcaktuara (objekti, termat e references specifikimet teknike). Sherbimi i kerkuar do të jetë i përsëritshëm/i vazhdueshëm për një periudhë kohore prej 12 muaj. |

**2.7 Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë:**

**Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: ___** (*Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)*

**2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:**

| | |
|---|---|
| Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike . | Nuk do të ketë rihapje të konkursit.<br><br>Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik me të suksesshëm, i cili do të ofrojë çmimin më të ulët të ofertës.<br><br>Dhënia e kontratave do të bëhet nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia e Tiranës.<br><br>Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, Autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik, fitues përkatës, të japë ofertën e tij.<br><br>Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, bëhet në formë të shkruar, ose elektronike (e-mail, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.<br><br>Sasitë e parashikuara për shërbimet që do të kryhen janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato. **Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej sherbimin për më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara** (por në çdo rast brenda |

| | |
|---|---|
| | vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër).<br><br>Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendos të bej sherbimin për më pak apo më shumë sesa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos beje asnjë nga këto sherbime për disa zera.<br><br>Çmimet për njësi janë përcaktuar në Formularin e Çmimit të Ofertës. Çmimet e njësive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër. |

**2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

**2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër**

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **3,365,000 (tre milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa Tvsh**
2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa shërbime, **shumatorja e çmimeve për njësi është** _________

3. Burimi i financimit: **Bashkia Tiranë**

4. Kodi Output: 6026300

5. Tipi:

Investime □ Kodi: ______ Vlera: _____

Shërbime **X** Kodi: ______ Vlera: **3,365,000 lekë pa Tvsh**

**2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:**
**12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit te Marrëveshjes Kuadër.**

**2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

| |
|---|
| **Kohëzgjatja në muaj: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit te Marrëveshjes Kuadër** |

**2.12 Vendi i kryerjes së shërbimeve: sipas kërkesave të Autoriteti Kontraktor**

**2.13 Ndarja në Lote:**

**Po** □ **Jo** X

*Nëse po,*

**2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:**

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

1.___________________________

2.___________________________

**2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:**

□ një Lot,

□ disa Lote,

□ të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:**

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi __________

**2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:**

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

________________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________________
________________________

**2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):**

**Po** □ **Jo** □

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

________________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________________

**2.15 Pranohen variantet:**

**Po** □ **Jo** □

**2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | □ | **Jo** | X |

**Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:**
*(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)* ________________________________

**2.15.2 Autoriteti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | □ | **Jo** | X |

**Shënime të tjera** *(nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti kontraktor)*

___________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________________
_______________________________________________________________________________

**2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | □ | **Jo** | X |

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:**

_______________________________________________________________________

**2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | □ | **Jo** | X |

**2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | □ | **Jo** | X |

## Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

**3.1 Sigurimi i ofertës:** (*e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e sigurimit të ofertës është **67,300 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind) lekë**.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 ____________________ (*shuma,monedha)*
*Loti 2* ____________________ *(shuma monedha)*

**3.1.2** Autoriteti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit,
**Kodi i Institucionit: 210 18 15**

**3.1.3** Autoriteti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:
i. garancisë bankare X
ose
ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

**3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150** ***(njëqind e pesëdhjetë) ditë***

**<u>Seksioni 4: Procedura</u>**

**4.1 Lloji i procedurës: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

**4.2. Është përdorur njoftimi paraprak:**

**Po** □ **Jo** X

Nëse Po, numri i referencës është _____________________

**4.3 Procedurë e rishpallur:**

**Po** □ **Jo** X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit
_____________________________________________________________________________

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit ___________________________

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____________________________(*shuma , monedha*)

**4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) [3]**Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto** □

Sipas rëndësisë:

[3] *Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto", ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.*

-çmimi  pikët

-________  pikët 

-________   pikët 

-________  pikët 



**<u>OSE</u>**

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

**<u>Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi</u>** (*Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).*

**4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:**

Data: **25.09.2026 ora 11:00**

Vendi: www.app.gov.al

**Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.**

**4.6 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

**Shqip** X **Anglisht** 

________________

**Seksioni 5:Informacione shtesë:**

**5.1 Dokumente me pagesë** *(zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):*

**Po**  **Jo** X

*Nëse po*

**Monedha** __________ **Çmimi** ________

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (**kur është e aplikueshme)

**Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:**

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të  kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi 14.09.2026

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrimit*]

**FTESË PËR OFERTË**

(*shënoni emrin e Autoritetit Kontraktor*) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për kryerjen e shërbimeve në vijim:

…………………………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………

(*jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasisë siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit*:

**Vendi i kryerjes së shërbimit**: (jepni një përshkrim të shkurtër*)*

**Koha e realizimit të shërbimit/eve**: Shërbimi duhet të realizohet ____________

**Ofertat duhet të paraqiten në:**
………………………………………………………………………………………*[jepni adresën e saktë*]

**Afati i fundit për pranimin e ofertave:**

……………………………………………………………………………………………………

[Përcaktoni datën dhe orën]

**Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese** ________________________________________

**Forma e komunikimit**:

Forma shkresore □ Forma elektronike (e-mail, faks, etj.) □

**NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

**Emri:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
**Adresa:** Rruga "Bilal Golemi", Godina nr. 29, Tiranë, Shqipëri
**Tel/Faks:**
**E-mail:** prokurimetapr@gmail.com
**Adresa e ueb-faqes:** www.aprtirana.al
**Personi/at përgjegjës për prokurimin (emri, e-mail):** Odeta Mersini

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF 99665-09-14-2026**

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Shpenzime për qiramarrje aparate dhe paisje teknike, makineri"**
**5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): CPV):**

**Projektor 30191200-6, Projektor per video 38652120-7 , Karrige 39112000-0**

**6. Fondi limit**: **3,365,000 (tre milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa Tvsh**
**7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj nga data e nëenshkrimit të marrëveshjes kuadër.**
**8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 25.09.2026 Ora: 11:00**
**9. Procedurë e Rishpallur:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | ☐ | **Jo** | X |

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit______________________________________________________________________

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit ____________________________

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit ______________________________(*shuma* , *monedha*)

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I**

**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

| ☐ Shërbime: Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër _____ | | |
|---|---|---|
| **Numri i kontratës** | **Titulli i kontratës** | **Përshkrimi i shkurtër i kontratës** |
| **01** | __________ | _______________ |
| **02** | __________ | _______________ |
| **03** | __________ | _______________ |
| **…** | __________ | _______________ |

Shënim: Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti kontraktor dhe orientues për palët në proces.

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Faks ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe ____________________________________________

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ______________________________________________

E-mail ____________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit: ______________________________**

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: ______________________________**

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:_________________________**

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _______________________**

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):_______________**

**8. Fondi limit :______________________________________________**

**9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:**

________________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________________

______________________________________

**10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:___________**

**<u>Shënim:</u>**

**Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor:**

Emri ___________________________________________

Adresa ___________________________________________

Tel/Faks ___________________________________________

E-mail ___________________________________________

Ueb-faqe ___________________________________________

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ___________________________________________

E-mail ___________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit: ______________________________**

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër:______________________________**

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:________________________**

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër :_______________________**

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):_______________**

**8. Fondi limit:** ___________________________________________

**9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:**

**_____________________________________________________________________________________**

**_____________________________________________________________________________________**

**______________________________________**

**10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:**

**_____________________________________________________________________________________**

**_____________________________________________________________________________________**

**__________________________________________________________________________________**

**11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: _______________________________**

**12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):______________________________________**

**13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: ________________________**

**Dhe afati i ri (nëse është rasti):** ____________________________

**14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:**

Emri_____________________________

NIPT: ________________________

Adresa ___________________________

Kontaktet __________________________

15. **Data e nënshkrimit të modifikimit :**______________________

16. **Burimi i financimit:** ________________________________

17. **Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti kontraktor**_______________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________

# DOKUMENTAT E TENDERIT

**Përmbajtja:**

**Seksioni I:** **<u>Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)</u>**

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit te Kontratës.

**Seksioni II:** **<u>Shtojcat</u>**

Seksioni II përfshin Shtojcat, të cilat duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor si, specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, grafiku i ekzekutimit dhe termat e referencës.

**Seksioni III.** **<u>Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)</u>**

Seksioni III përmban kushtet e përgjithshme dhe të veçanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

**Seksioni IV:** **Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që  duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

# Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

## A. TË PËRGJITHSHME

**1. Objekti prokurimit**

1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës.

2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).

**2. Operatorët Ekonomikë**

a)"Operator ekonomik" është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në treg, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

1.1. Të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare.

1.2. BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të cojë në refuzimin e Ofertës.

**3. Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit**

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

**4. Ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit**

1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.
2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë sc është bërë publikimi i Dokumentat ë Tenderit.

3. Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e Ofertave, autoriteti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e ofertave. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e ofertave, autoriteti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e ofertave me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

## B. PËRGATITJA E OFERTAVE

**5 Shpenzimet e ofertimit**

Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së tij, dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.

**6.Gjuha e Ofertës**

Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.

**7. Dokumentet përbërëse të Ofertës**

Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti kontraktor.

**8. Formularët e Ofertës dhe Listat Çmimeve**

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar;

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

**9. Ofertat Alternative**

Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.

**10. Përllogaritja e Ofertës Ekonomike**

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës Ekonomike do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.
2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të dorëzohen, sasitë dhe çmimin e tyre.
3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës,

atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë), sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë, në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe, duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës Ekonomike, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Mallrat pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

5. Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini–konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

**11. Monedhat**

Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës.

**12. Provueshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik**

Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.

**13. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës**

1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.
2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:

   a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit kontraktor;

   b) Garanci bankare;

   c) Garanci sigurimi .

   Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor e refuzon Ofertën.

Nëse autoriteti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

**14. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave**

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

## C. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

**15. Paraqitja e Ofertave**

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualet përkatëse.

11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për Furnizimin e Mallrave; Njoftimi Nr. __.

**"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA -------------- d/m/v, në orën------------" .**

**16. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave**

Oferta duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nëse autoriteti zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

**17. Ofertat me vonesë**

Autoriteti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i prokurimit elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

**18. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet**

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të ofertave.

2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".

3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.

**19. Hapja e Ofertave**

Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

## D. SHQYRTIMI I OFERTAVE

**20. Konfidencialiteti**

Autoriteti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

**21. Sqarimi i ofertave**

1. Autoriteti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkese nga Autoriteti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

**22. Përgjegjshmëria e ofertave**

1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

(a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
(b) “**Rezervim**” është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
(c) “**Mospranim”** është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

## F. VLERËSIMI I OFERTAVE

**23. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik**

1. Për një pjesë të kritereve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).

**24. Konvertimi në valutë të vetme**

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

**25. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese**

1. Autoriteti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kritereve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

**Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:**

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

Po = Pk1+Pk2+Pk3+.....

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) **Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:**

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 ____Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) **Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:**

Pk1= Ok1 x Pmaxk1 /Vmax k1

Vmaxk1_____Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 ______ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, autoritetet kontraktore mund të përdorin kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

**Propozimi Teknik do të ketë 80 pikë**

**Kriteret e Vlerësimit** **Pikët**

**(i) Përvoja per Punë të Ngjashme të operatorit ekonomik**

**Nënkriteret**[4]

**i/a Përvoja për punë të ngjashme**

Operatorët ekonomikë, mund të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

**i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë**

Operatorët ekonomikë mund të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

**(ii) Metodologjia e Propozuar**

**Nënkriteret**

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

ii.c. Organizimi i Stafit

**ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:** Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës.

**ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit.

[4] *Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit nënkritereve.*

Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

**ii/c. Organizimi dhe Stafi:** Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

**(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar**

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm;

b. Eksperienca në fushën përkatëse;

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. **Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:**

**Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik
Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar
Ç – Çmimi Ofertues i Radhës *(duke filluar nga çmimi më i ulët)*

**Pe = 100 x Çu / Ç**
(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

**Vlerësimi përfundimtar**

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)**

**pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

**Oferta më e mirë = X + Y**

**<u>Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:</u>**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

**SHENIM**: 1. Autoriteti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën e prokurimit të pavlefshme.

2. Autoriteti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

**22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

**1**. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime arithmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime arithmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

**(a)** Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

**(b)** Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

**(c)** Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

**2.** Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

**2.1** Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + … On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ......... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

**3.** Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

**4**. Procesi i hedhjes se shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## D. DHËNIA E KONTRATËS

**23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;

b) garanci bankare;

c) garanci nga shoqëri sigurimi.

## DH. ANKESAT

**25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

**26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

   a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

   b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

   c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

   d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;

   e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

   Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

**SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**


Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial........................................................................

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike .....................................................................

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit ..........................................

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve te Përzgjedhjes se Ofertuesve ............................................

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.............................................................

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit..................................................................

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**[5]

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

**(a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**(b)** Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

**(c)** Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**(d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

**(e)** Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ------------ **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

**(f)** Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ------------ **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

[5] *Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.*

| | |
|---|---|
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë _________________** | |

**Shtojca 2**.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**

**Data**: ___________________________________

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____________________________________

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): ____________________________________________________

**Monedha**: ____________

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike** | **Sasia** | **çmimi për njësi** | **Çmimi total (*3* x *4X*)** | |
| **1.** | Foni 3 000 W për aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentash, pult fonie, amplifikator, kablla korenti etj) | 23 | | | |
| **2.** | Foni 5 000 W për aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentash, pult fonie, amplifikator, kablla korenti etj) | 17 | | | |
| **3.** | Foni 10 000 W, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentash, pult fonie, amplifikator, kablla korenti, foltore, etj) | 6 | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **4.** | Ekran LED me rezolucion jo më shumë se 2.6 mm (për ambient të jashtëm) përmasa paneli 50 cm × 100 cm. Jo më pak se 80 m² (duke përfshirë laptop, server video, videoprocesor) | 6 | | | |
| **5.** | Ekran LED me rezolucion jo më shumë se 2.6 mm (për ambient të jashtëm) përmasa paneli 50 cm × 100 cm. Jo më pak se 150 m² (duke përfshirë laptop, server video, videoprocesor) | 4 | | | |
| **6.** | Pajisje ndriçimi (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 40 njësi ndriçimi. P.sh.: ndriçues linear, ndriçues wash RGB, ndriçues me kokë të rrotullueshme, pult ndriçimi etj) | 10 | | | |
| **7.** | Pajisje ndriçimi (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 80 njësi ndriçimi. P.sh.: ndriçues linear, ndriçues wash RGB, ndriçues me kokë të rrotullueshme, pult ndriçimi etj) | 6 | | | |
| **8.** | Platformë skenike (Stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m² | 7 | | | |
| **9.** | Platformë skenike (Stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 60 m² | 7 | | | |
| **10.** | Platformë skenike (Stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 120 m² | 3 | | | |
| | | | | **Çmimi total** | _____________ |

| | |
|---|---|
| **Çmimi Neto pa TVSH** | |
| **TVSH (%)** | |

| | |
|---|---|
| **Çmimi total me TVSH:** | |
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë ________________** | |

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5.**

(*[6]Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

**DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Unë i nënshkruari _____________________, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "..............................................." për procedurën e prokurimit me objekt______________ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "…………………………………….." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ………………………………………………………., është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës ________________**

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

[6] *Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.*

**Shtojca 6 .**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efiçencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

| Nr. | Shërbimi | SPECIFIKIMET TEKNIKE |
|---|---|---|
| **1** | **Foni 10 000 W**, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentesh, mikser fonie, amplifikatorë të fuqishëm, mikrofona pa kabëll, të dorës (handheld), stativë mikrofoni me këmbë të palosshme, kabllo korenti, foltore, etj.) | • **Boks pasiv me mundësi për t'u varur (sistem Line Array):** Boks pasiv 2 rrugësh me dy bokse me përmasa 8" secili për frekuencat e ulëta dhe një Boks me përmasa 3" i kompresuar për frekuencat e larta. Të ketë fuqi të paktën 350 W. Boksi të vijë në formë "Line Array", me të gjithë aksesorët e nevojshëm për ta varur në lartësi dhe për të kombinuar të paktën 12 copë së bashku. Këndi i mbulimit horizontal për frekuencat e larta të ketë të paktën tre mundësi zgjedhje, 110 °, 70 ° dhe 90 °. Elementet e varjes së boksit duhet të lejojnë zgjedhjen e të paktën tetë këndeve të ndryshme kur bokset montohen njëri pas tjetrit. Kasa e boksit duhet të jetë e përbërë nga material drusor dhe të jetë e durueshme ndaj ujit me nivel izolimi të paktën IP55. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • **Amplifikator fuqie për foni të varur sistem Line Array.** Amplifikator digjital që të ketë të paktën 4 hyrje sinjali dhe 4 dalje fuqie me të paktën 3300 W RMS për secilën dalje në rezistencën 2.7 ohm dhe të paktën 2600 W RMS në rezistencën 4 ohm. Amplifikatori të mbështesë të paktën dy hyrje sinjali digjitale të standardit AES/EBU. Amplifikatori të ketë të integruar një sistem digjital për menaxhimin e sinjalit audio dhe procesimin e tij. Arkitektura e amplifikatorit të jetë e klasit D dhe të mbështesë frekuencat të paktën nga 20 Hz deri në 20 kHz. Amplifikatori të ketë aftësinë për t'u kontrolluar totalisht në distancë me anë të një program kompjuterik që lejon ndryshimin e parametrave në kohë reale dhe monitorimin e të gjithë parametrave. Procesori i integruar të jetë i tipit 32-bit dhe me frekuencë kampionimi 96 kHz. EQ e integruar të ketë të paktën 8 filtra IR dhe 3 filtra FIR. Të ketë limiter të integruar që ndihmon në mbrojtjen e bokseve. Amplifikatori duhet të ketë një ushqyes universal që lejon të funksionojë në një interval tensioni nga 100 V deri në 240 V.<br><br>• **Boks aktiv për muzikë dhe monitor skene:** Boks aktiv me dy rrugë, me funksion për monitor skene. Të ketë një amplifikator të integruar me fuqi të paktën 400 W RMS i klasit D. Boksi të ketë një Boks për frekuencat e ulëta me përmasë 10" dhe një Boks për frekuencat e larta me përmasë të paktën 1". Boksi i frekuencave të larta të jetë i montuar në formë koaksiale në atë të frekuencave të ulëta. Hinka e boksit të frekuencave të larta të jetë e rrotullueshme për të krijuar këndet 90x60 ° ose 60x90 ° (Horizontalisht/Vertikalisht). Boksi të ketë të integruar një procesor digjital për ekualizimin e tingullit. Në panelin e kontrollit të ketë mundësinë për të zgjedhur të paktën dy paracaktime të gatshme për performancë Live dhe Playback. Gjithashtu procesori të ketë të integruar një limiter automatik për mbrojtjen e boksit. Brezi i frekuancave që boksi duhet të arrijë të riprodhojë të jetë të paktën 60 Hz deri në 19 kHz. Niveli i presionit të zërit të jetë të paktën 128 dB. Boksi të ketë të paktën një konektor XLR të balancuar për hyrjen e sinjalit dhe një konektor XLR të balancuar për daljen e sinjalit. Konektori për hyrjen e sinjalit të ketë mundësinë që të konfigurohet për hyrje mikrofonike ose Line.<br><br>• **Boks aktiv me frekuencë të ulët:** Boks aktiv me frekuencë të ulët me amplifikator të klasit D të integruar dhe fuqi minimalisht 1600 W RMS. Përmasat e boksit të jenë 18". Boksi të jetë i përshtatshëm për t'u varur në lartësi (Line Array) dhe të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që sigurojnë montimin e tij në skenë. Brezi i frekuencave që boksi duhet të arrijë të riprodhojë të jetë të paktën 35 Hz deri në 110 Hz. Niveli i presionit të zërit të arrijë të paktën 139 dB. Ushqyesi i amplifikatorit të boksit të jetë i tipit SMPS me tension 100–240 V dhe frekuencë 50 ~ 60Hz.<br><br>• **Boks pasiv me frekuencë të ulët me mundësi për t'u varur (Line Array):** Subwoofer me dy bokse 18 inç me drejtues ekskursioni të lartë dhe ajrim laminar të optimizuar për të maksimizuar efikasitetin |

| | | |
|---|---|---|
| | | LF - i vendosur në modele të gjithëdrejtimit ose kardioid në konfigurime të grumbulluara ose të fluturuara.<br>• **Boks pasiv me profil të ulët:** Boks pasiv me dy rrugë me një Boks 5” për frekuenca të ulëta si dhe një Boks me përmasa të paktën 1”, i kompresuar, për frekuencat e larta. Boksi i frekuencave të larta të jetë i montuar në formë koaksiale me Boksin e frekuencave të ulëta. Kasa e boksit duhet të jetë e përbërë nga material drusor dhe pjesa përpara Boksit të ketë një rrjetë metalike e cila është e trajtuar për të rezistuar hyrjen e grimcave të ngurta, me një nivel izolimi të paktën IP30. Boksi duhet të riprodhojë një brez frekuencash ndërmjet 95 Hz në 20 kHz dhe të ketë një mbulim të paktën 110 °. Boksi të ketë fuqi të paktën 60 W.<br>• **Pult fonie digjital me jo më pak se 128 kanale.** Mikser audio digjital i pajisur me 3 ekrane, me prekje 12 inç, me mundësi vizibiliteti në dritën e diellit. Mikseri të jetë i pajisur me 24 + 2 faderë të motorizuar. Mikseri duhet të pranojë deri në 192 hyrje dhe 28 dalje. Mikseri të ketë të paktën 5 porta USB 2.0, 2 porta Ethernet dhe 1 portë fibër optike. Të mundësojë regjistrimin e njëkohshëm të deri në 128 kanaleve audio.<br>• **Mikrofon pa kabëll:** Mikrofon pa kabëll që përdoret për fjalime dhe muzikë. Mikrofoni të vijë bashkë me bazën që shërben për marrjen e sinjalit. Baza duhet të mbështesë të paktën 2 mikrofona që funksionojnë njëkohësisht. Sistemi pa kabëll duhet të jetë tërësisht digjital. Mikrofoni duhet të mbështesë inkriptimin e sinjalit të transmetuar me kapacitetin 512-bit. Baza e mikrofonit, veç daljes analoge të sinjalit, duhet të ketë edhe dalje digjitale si DANTE dhe AES EBU. Brezi i frekuencave që duhet të mbështesë mikrofoni: 25 – 20 000 Hz.<br>• **Mikrofona konvencer, jo më pak se 45 copë:** Mikrofona konvencer, të përshtatshëm për përdorim në koncerte dhe interpretim live.<br>• **Mikrofon për instrument:** Mikrofon për instrument frymor që mund të kapet në instrument. Mikrofoni të jetë me kondensator dhe të funksionojë me 9 deri në 52 V. Brezi i frekuencave që duhet të funksionojë: 60 Hz–20 kHz. Polariteti të jetë kardioid.<br>• **Set mikrofonash për bateri:** Seti i mikrofonave për bateri të përbëhet nga të paktën 7 mikrofona që të shërbejnë për të kapur një gamë të gjerë instrumentesh si drum, bas drum, overhead për baterinë dhe mikrofon për amplifikatorë kitare.<br>• **Mikrofon foltoreje:** Mikrofon për foltore me gjatësi 40 cm. Kapsula e mikrofonit të jetë e çmontueshme për të mundësuar instalimin e disa kapsulave të ndryshme. Mikrofoni të shoqërohet me kapsulë kardioide dhe superkardioide.<br>• **Mikrofon për prezantues:** Mikrofoni për prezantues është i montueshëm në pjesën e kokës. Të ketë të paktën dy kapje që mbështeten në vesh. Mikrofoni dhe kapsula të kenë ngjyrë bezhë të |

| | | |
|---|---|---|
| | | hapur. Polariteti i kapsulës të jetë superkardioid. Mikrofoni të shoqërohet me një transmetues valor që montohet në trup dhe një marrës valor që shërben për marrjen e sinjalit të transmetuar.<br><br>• **Përforcues sinjali audio:** Përforcuesi i sinjalit audio të ketë të paktën dy hyrje jack ¼" dhe një hyrje XLR. Përforcuesi duhet të stabilizojë dhe balancojë sinjalin audio që vjen direkt nga instrumentet muzikore.<br><br>• **Shpërndarës sinjali audio:** Shpërndarës sinjali audio digjital me të paktën 32 kanale hyrëse dhe 16 kanale dalëse. Të ketë të paktën 2 dalje digjitale AES/EBU me konektorë XLR të balancuar. Secili kanal hyrës, me konektorë XLR të balancuar, të ketë opsion për aktivizim fuqie +48V për mikrofonat që kërkojnë "phantom power".<br><br>• **Set pajisjesh për DJ.** Set pajisjesh profesionale për performancë DJ, i përbërë nga pajisje riprodhimi audio dhe mikser DJ.<br><br>• **Foltore e branduar.** Foltore transparente, e cila të ofron mundësinë e brandimit sipas dizajnit të Autoritetit Kontraktor, e përshtatshme për fjalime dhe aktivitete të kategorive të ndryshme. |
| **2** | **Foni 5000 W**, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentesh, mikser fonie, mikrofona pa kabëll, të dorës (handheld), stative mikrofoni me këmbë të palosshme amplifikator, kabllo korenti, etj) | • **Boks aktiv për muzikë:** Boks me dy rrugë aktiv me frekuencë të ulët 15'' dhe frekuencë të lartë 1.4" me fuqi 900 W, me amplifikator të integruar të klasit D me fuqi minimalisht 900 W RMS. Të ketë mundësi kontrolli me RDNet me program kompjuterik për analizën e frekuencave dhe optimizimin e sistemit në distancë.<br><br>• **Boks aktiv për fjalim:** Boks me dy rrugë me Boks 10" dhe frekuencë të lartë 1" me amplifikator të integruar. Boksi të ketë fuqi të paktën 500 W dhe nivel presioni zanor deri në të paktën 122 dB.<br><br>• **Pult fonie digjital me 32 kanale:** Pult fonie digjital. Pulti duhet të ketë të paktën 32 hyrje mono, si dhe 32 faderë të motorizuar. Pulti të ketë 32 hyrje dhe 16 dalje analoge. Pulti duhet të mbështesë protokollin Dante dhe të menaxhohet nëpërmjet programit Dante Controller. Pulti të shoqërohet me një "stagebox" (pajisje për ndërlidhje sinjali) i cili mundëson shtimin e 32 hyrjeve dhe 16 daljeve. Pulti të ketë të integruar një ekran digjital me anë të të cilit të kontrollohen dhe të rregullohen parametra të ndryshëm. Pulti të krijojë mundësinë që të kryejë regjistrim multi-track me 32 kanale. Pulti duhet të krijojë mundësi për procesim zëri në çdo hyrje dhe dalje.<br><br>• **Mikrofon vokali me kabëll:** Mikrofon vokali dinamik me kabëll. Polariteti superkardioid. Brezi i frekuencave 50 Hz – 16 kHz. Mikrofoni të jetë i përshtatshëm për t'u përdorur në koncerte dhe këngëtarë live.<br><br>• **Set pajisjesh për DJ.** Set pajisjesh profesionale për performancë DJ, i përbërë nga pajisje riprodhimi audio dhe mikser DJ. |
| | **Foni 3000 W**, aktivitete (foni e kompletuar me bokse | • **Boks aktiv për muzikë:** Boks me dy rrugë aktiv me frekuencë të ulët 15'' dhe frekuencë të lartë 1.4" me fuqi 900 W, me amplifikator të |

| | | |
|---|---|---|
| **3** | pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentesh, pult fonie, amplifikator, kabllo korenti, etj) | integruar të klasit D me fuqi minimalisht 900 W RMS. Të ketë mundësi kontrolli me RDNet me program kompjuterik për analizën e frekuencave dhe optimizimin e sistemit në distancë.<br><br>• **Boks aktiv për fjalim:** Boks me dy rrugë me Boks 10", dhe frekuencë të lartë 1" me amplifikator të integruar. Boksi të ketë fuqi të paktën 500 W dhe nivel presioni zanor deri në të paktën 122 dB.<br><br>• **Pult fonie digjital me 16 kanale:** Pult fonie digjital. Pulti duhet të ketë të paktën 16 hyrje mono, si dhe 16 faderë të motorizuar. Pulti të ketë 16 hyrje dhe 8 dalje analoge. Pulti duhet të mbështesë protokollin Dante dhe të menaxhohet nëpërmjet programit Dante Controller. Pulti të shoqërohet me një "stagebox" (pajisje për ndërlidhje sinjali) i cili mundëson shtimin e 16 hyrjeve dhe 8 daljeve. Pulti të ketë të integruar një ekran digjital me anë të të cilit të kontrollohen dhe të rregullohen parametra të ndryshëm. Pulti të krijojë mundësinë që të kryejë regjistrim multi-track me 16 kanale. Pulti duhet të krijojë mundësi për procesim zëri në çdo hyrje dhe dalje.<br><br>• **Mikrofon vokali me kabëll:** Mikrofon vokali dinamik me kabëll. Polariteti superkardioid. Brezi i frekuencave 50 Hz – 16 kHz. Mikrofoni të jetë i përshtatshëm për t'u përdorur në koncerte dhe këngëtarë live.<br><br>• **Set pajisjesh për DJ.** Set pajisjesh profesionale për performancë DJ, i përbërë nga pajisje riprodhimi audio dhe mikser DJ. |
| **4** | **Ekran LED për ambient të jashtëm – jo më pak se 80 m²** me hap pikseli (pixel pitch) jo më të madh se 1,9 mm (duke përfshirë laptop, server video, videoprocesor, strukturë mbajtëse për ekranin LED). | • **Ekrani LED me hap pikseli (pixel pitch) jo më të madh se 1,9 mm për ambient të jashtëm.** Përmasat e një paneli LED janë 50 cm × 100 cm. Jo më pak se 80 m². Ekrani LED është i përshtatshëm për video dhe imazhe të formateve të ndryshme.<br><br>• **Strukturë mbajtëse për ekranin LED**: Strukturë alumini për mbajtje peshe. Struktura të jetë lehtësisht e montueshme dhe e çmontueshme në përmasa të rregulluara sipas kërkesave të ekranit LED.<br><br>• **Videoprocesor: procesor** video për përdorimin e ekranit LED. Procesori i videos duhet të ketë mundësinë për hyrje DVI, VGA dhe USB.<br><br>• **Server video.** Media server, të ketë të paktën 20 shtresa Full HD 1080p, hyrje video të paktën 1 HD-SDI, 1 HDMI dhe 2 VGA. Dalje video të paktën 2 DVI, 1 HDMI dhe 2 VGA.<br><br>• **Laptop:** Laptop video për të bërë të mundur shfaqjen e imazheve video në ekranin LED. |
| **5** | **Ekran LED për ambient të jashtëm – jo më pak 150 m²** me hap pikseli (pixel pitch) jo më të madh se 1,9 mm (duke përfshirë laptop, server video, videoprocesor, | • **Ekrani LED me hap pikseli (pixel pitch) jo më të madh se 1,9 mm për ambient të jashtëm.** Përmasat e një paneli LED janë 50 cm × 100 cm. Jo më pak se 150 m². Ekrani LED është i përshtatshëm për video dhe imazhe të formateve të ndryshme. |

| | | |
|---|---|---|
| | strukturë mbajtëse për ekranin LED). | • **Strukturë mbajtëse për ekranin LED**: Strukturë alumini për mbajtje peshe. Struktura të jetë lehtësisht e montueshme dhe e çmontueshme në përmasa të rregulluara sipas kërkesave të ekranit LED.<br><br>• **Videoprocesor: procesor** video për përdorimin e ekranit LED. Procesori i videos duhet të ketë mundësinë për hyrje DVI, VGA dhe USB.<br><br>• **Server video.** Media server, të ketë të paktën 20 shtresa Full HD 1080p, hyrje video të paktën 1 HD-SDI, 1 HDMI dhe 2 VGA. Dalje video të paktën 2 DVI, 1 HDMI dhe 2 VGA.<br><br>**Laptop:** Laptop video për të bërë të mundur shfaqjen e imazheve video në ekranin LED. |
| **6** | **Pajisje ndriçimi jo më pak se 70 njësi** (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 70 njësi ndriçimi. P.sh.: ndriçues linear, ndriçues wash RGB, ndriçues me kokë të rrotullueshme, pult ndriçimi etj) | • **Konfigurimi duhet të përmbajë jo më pak se 70 njësi funksionale ndriçimi në total, të përzgjedhura nga kategoritë e mëposhtme sipas kërkesave të aktivitetit. Robot Spot:** Roboti të jetë me llambë të paktën 250 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Spot, por të mos jetë i limituar edhe për përdorim si Beam dhe Wash. Këndet e zoomit që duhet të mbështesë: 2.2 – 24° për Beam, 2.5 – 24° për Spot dhe 15 – 45° për wash. Të ketë të paktën 8 “gobo” të motorizuara dhe 12 gobo statike. Të ketë një prizëm linear me të paktën 4 faqe dhe një prizëm me 8 faqe që rrotullohet. Të ketë të paktën 10 ngjyra të ndryshme, përfshi CTO, CTB, UV. Fokusi të jetë i motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br><br>• **Robot Beam:** Roboti të jetë me llambë të paktën 180 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Beam. Këndi i lentes të jetë 1° - 3.8°. Të ketë të paktën 17 gobo. Të ketë të paktën një prizëm me 8 faqe. Të ketë frost, zoom të motorizuar, fokus të motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br><br>• **Robot wash:** Roboti të jetë me LED RGBW me fuqi të paktën 120 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Wash. Intensiteti i dritës të jetë të paktën 2000 lumen. Roboti të ketë zoom të motorizuar me kënde 10°–60°. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br><br>• **Ndriçues wash RGB:** Ndriçues wash jo i motorizuar dhe të ketë të paktën 4 LED RGB me nga 30 W secili. Këndi i dritës të jetë të paktën 60°. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX.<br><br>• **Dritë e bardhë mediatike.** Ndriçues i bardhë mediatik me fuqi 300 W me LED. Ndriçuesi të krijojë mundësinë për ndriçim të bardhë të ngrohtë dhe të ftohtë nga 3 000 K–8 000 K. Këndi i ndriçimit 15°-50°. |

Ndriçuesi të jetë i përshtatshëm për një ndriçim sa më funksional për kamera me cilësi të lartë.

- **Pult ndriçimi**. Mikser ndriçimi me 4 universe (4 × DMX) me mundësi lidhjeje të një monitori nëpërmjet hyrjes VGA ose DVI. Mikseri të ketë aftësinë të mbajë deri në 32 universa DMX dhe deri në 8192 parametra të ndryshëm. Mikseri të ketë mundësinë e dy llambave për të punuar edhe në errësirë.

- **Dritë skenike (për folësin).** Ndriçues skenik RGBW me llambë halogjene 575 W. Ndriçuesi është i përshtatshëm për të fokusuar në skenë folësin apo këdo që është në skenë. Këndi i ndriçimit është 13° - 19°.

- **Blitz për efekte speciale.** Ndriçues blitz me llambë LED-Xenon 3000 W. Ndriçuesi është i përshtatshëm për përdorim në koncerte për të krijuar efektin e blitzit. Ndriçuesi kontrollohet nga protokolli DMX. Temperatura e dritës është 5700 K. Ndriçuesi shoqërohet me të gjithë aksesorët përkatës për t'u instaluar.

- **Tym skenik.** Pajisje tymi skenik. Pajisja krijon mundësinë që lëngun përkatës ta kthejë në efekt mjegull. Përdoret për efekte skenike, gjithashtu, për të bërë të dukshme edhe efektet e ndriçimit. Pajisja kontrollohet nga protokolli DMX.

- **Robot WashBeamLED me fuqi llambë led mbi 700 W**. Roboti të jetë me fuqi llambë mbi 700W si edhe të përbëhet nga 18 llamba LED me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë gamë zmadhimi 4° - 50°. Roboti të përbëhet nga 4 unaza LED të kontrollueshme individualisht.

- **Robot BeamLED me fuqi llambë led mbi 450 W.** Roboti të jetë me fuqi llambë minimalisht 450 W si edhe të përbëhet nga 12 llamba LED me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë gamë zmadhimi 4° - 60°. Duhet të ketë efekt elektronik strobe me shpejtësi të ndryshueshme deri në 20 Hz. Gama e lëvizjes së Pan të jetë 450°. Konsumi i energjisë të jetë maksimalisht 450 W në 230 V / 50 Hz.

- **Robot WASH me fuqi llambë 1200 W**. Roboti të ketë Llambë shkarkimi 1200W. Të ketë 2 × 5 gobo rrotulluese të indeksueshme. Të mundësojë efekt strobe 2 - 10 Hz si edhe të ketë efekt zoom dhe fokus të motorizuar. Gama e lëvizjes së Pan dhe Tilt të jetë 540°/267°. Pesha e pajisjes të jetë jo më pak se 40 kg si edhe të mundësojë fokusim nga 2 m deri në pafundësi.

- **Robot Spot me fuqi llambë 400 W**. Roboti të ketë llambë me fuqi minimale 400 W si edhe të ketë një zmadhim që varion nga 4° në 50° (raporti 1:12 ). Roboti të ketë një fokusim elektronik për një rreze drite të përkryer të mprehtë përgjatë gjithë gjatësisë së saj si edhe të ketë 15 filtra të veçantë me ngjyra. Pesha e robotit të jetë jo më shumë se 35 kg.

| | | |
|---|---|---|
| | | • **Robot Hybrid Spot me fuqi llambë mbi 400 W**. Roboti të ketë një llambë minimalisht 470 W si edhe 7 500 K. Diametri i lentes së robotit të jetë 150 mm. Roboti të jetë i pajisur me 9 gobo të rrotullueshme dhe 14 gobo statike. Roboti të mos konsumojë më shumë se 690 W.<br><br>• **RGB Verbuese/RGB Blinder.** Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga mbi 1800 llamba LED RGBW me intensitet drite 5700K. Hapja e dritës maksimale të jetë 110°. Temperatura të variojë nga 2 000 K–10 000 K. Konsumi maksimal i robotit të mos jetë më shumë se 470W.<br><br>• **Verbues/Blinder.** Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga 4 llamba 650 W secila. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX, i përshtatshëm për t'u vendosur në skena dhe ambiente të ndryshme. Ndriçuesi të shoqërohet me të gjithë aksesorët përkatës për t'u instaluar.<br><br>• **Dritë Skenike 1,7 kW e automatizuar.** Robot spot me fuqi maksimale 1 700 W. Të jetë i pajisur me llambë 6 000 K, me kapacitet zmadhimi dhe zvogëlimi të dritës nga 5˚-55˚. Niveli i ndriçimit të jetë 200 000 lx në 5 metra distancë.<br><br>• **Robot Profile.** Robot i pajisur me llambë LED multispektrale me fuqi 500W, i motorizuar për efektet e zmadhimit dhe fokusimit. Mund të përdoret si dritë mediatike profesionale. Duhet të ketë mundësi për vendosje deri në 6 gobo dhe me kënd nga 7-49˚. |
| **7** | **Pajisje ndriçimi jo më pak se 140 njësi** (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 140 njësi ndriçimi. P.sh.: ndriçues linear, ndriçues wash RGB, ndriçues me kokë të rrotullueshme, pult ndriçimi etj) | • **Konfigurimi duhet të përmbajë jo më pak se 140 njësi funksionale ndriçimi në total, të përzgjedhura nga kategoritë e mëposhtme sipas kërkesave të aktivitetit. Robot Spot:** Roboti të jetë me llambë të paktën 250 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Spot, por të mos jetë i limituar edhe për përdorim si Beam dhe Wash. Këndet e zoomit që duhet të mbështesë: 2.2 – 24° për Beam, 2.5 – 24° për Spot dhe 15 – 45° për wash. Të ketë të paktën 8 "gobo" të motorizuara dhe 12 gobo statike. Të ketë një prizëm linear me të paktën 4 faqe dhe një prizëm me 8 faqe që rrotullohet. Të ketë të paktën 10 ngjyra të ndryshme, përfshi CTO, CTB, UV. Fokusi të jetë i motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br><br>• **Robot Beam:** Roboti të jetë me llambë të paktën 180 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Beam. Këndi i lentes të jetë 1° - 3.8°. Të ketë të paktën 17 gobo. Të ketë të paktën një prizëm me 8 faqe. Të ketë frost, zoom të motorizuar, fokus të motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë |

**Shtojca 7.**

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br><br>• **Robot wash:** Roboti të jetë me LED RGBW me fuqi të paktën 120 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Wash. Intensiteti i dritës të jetë të paktën 2000 lumen. Roboti të ketë zoom të motorizuar me kënde 10°–60°. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br><br>• **Ndriçues wash RGB:** Ndriçues wash jo i motorizuar dhe të ketë të paktën 4 LED RGB me nga 30 W secili. Këndi i dritës të jetë të paktën 60°. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX.<br><br>• **Dritë e bardhë mediatike.** Ndriçues i bardhë mediatik me fuqi 300 W me LED. Ndriçuesi të krijojë mundësinë për ndriçim të bardhë të ngrohtë dhe të ftohtë nga 3 000 K–8 000 K. Këndi i ndriçimit 15°-50°. Ndriçuesi të jetë i përshtatshëm për një ndriçim sa më funksional për kamera me cilësi të lartë.<br><br>• **Pult ndriçimi**. Mikser ndriçimi me 4 universe (4 × DMX) me mundësi lidhjeje të një monitori nëpërmjet hyrjes VGA ose DVI. Mikseri të ketë aftësinë të mbajë deri në 32 universa DMX dhe deri në 8192 parametra të ndryshëm. Mikseri të ketë mundësinë e dy llambave për të punuar edhe në errësirë.<br><br>• **Dritë skenike (për folësin).** Ndriçues skenik RGBW me llambë halogjene 575 W. Ndriçuesi është i përshtatshëm për të fokusuar në skenë folësin apo këdo që është në skenë. Këndi i ndriçimit është 13° - 19°.<br><br>• **Blitz për efekte speciale.** Ndriçues blitz me llambë LED-Xenon 3000 W. Ndriçuesi është i përshtatshëm për përdorim në koncerte për të krijuar efektin e blitzit. Ndriçuesi kontrollohet nga protokolli DMX. Temperatura e dritës është 5700 K. Ndriçuesi shoqërohet me të gjithë aksesorët përkatës për t'u instaluar.<br><br>• **Tym skenik.** Pajisje tymi skenik. Pajisja krijon mundësinë që lëngun përkatës ta kthejë në efekt mjegull. Përdoret për efekte skenike, gjithashtu, për të bërë të dukshme edhe efektet e ndriçimit. Pajisja kontrollohet nga protokolli DMX.<br><br>• **Robot WashBeamLED me fuqi llambë led mbi 700 W**. Roboti të jetë me fuqi llambë mbi 700W si edhe të përbëhet nga 18 llamba LED me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë gamë zmadhimi 4° - 50°. Roboti të përbëhet nga 4 unaza LED të kontrollueshme individualisht.<br><br>• **Robot BeamLED me fuqi llambë led mbi 450 W.** Roboti të jetë me fuqi llambë minimalisht 450 W si edhe të përbëhet nga 12 llamba LED me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë gamë zmadhimi 4° - 60°. Duhet të ketë efekt elektronik strobe me shpejtësi të ndryshueshme deri në 20 Hz. Gama e lëvizjes së Pan të |

| | | |
|---|---|---|
| | | jetë 450°. Konsumi i energjisë të jetë maksimalisht 450 W në 230 V / 50 Hz.<br><br>• **Robot WASH me fuqi llambë 1200 W**. Roboti të ketë Llambë shkarkimi 1200W. Të ketë 2 × 5 gobo rrotulluese të indeksueshme. Të mundësojë efekt strobe 2 - 10 Hz si edhe të ketë efekt zoom dhe fokus të motorizuar. Gama e lëvizjes së Pan dhe Tilt të jetë 540°/267°. Pesha e pajisjes të jetë jo më pak se 40 kg si edhe të mundësojë fokusim nga 2 m deri në pafundësi.<br><br>• **Robot Spot me fuqi llambë 400 W**. Roboti të ketë llambë me fuqi minimale 400 W si edhe të ketë një zmadhim që varion nga 4° në 50° (raporti 1:12 ). Roboti të ketë një fokusim elektronik për një rreze drite të përkryer të mprehtë përgjatë gjithë gjatësisë së saj si edhe të ketë 15 filtra të veçantë me ngjyra. Pesha e robotit të jetë jo më shumë se 35 kg.<br><br>• **Robot Hybrid Spot me fuqi llambë mbi 400 W**. Roboti të ketë një llambë minimalisht 470 W si edhe 7 500 K. Diametri i lentes së robotit të jetë 150 mm. Roboti të jetë i pajisur me 9 gobo të rrotullueshme dhe 14 gobo statike. Roboti të mos konsumojë më shumë se 690 W.<br><br>• **RGB Verbuese/RGB Blinder.** Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga mbi 1800 llamba LED RGBW me intensitet drite 5700K. Hapja e dritës maksimale të jetë 110°. Temperatura të variojë nga 2 000 K–10 000 K. Konsumi maksimal i robotit të mos jetë më shumë se 470W.<br><br>• **Verbues/Blinder.** Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga 4 llamba 650 W secila. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX, i përshtatshëm për t'u vendosur në skena dhe ambiente të ndryshme. Ndriçuesi të shoqërohet me të gjithë aksesorët përkatës për t'u instaluar.<br><br>• **Dritë Skenike 1,7 kW e automatizuar.** Robot spot me fuqi maksimale 1 700 W. Të jetë i pajisur me llambë 6 000 K, me kapacitet zmadhimi dhe zvogëlimi të dritës nga 5˚-55˚. Niveli i ndriçimit të jetë 200 000 lx në 5 metra distancë.<br><br>• **Robot Profile.** Robot i pajisur me llambë LED multispektrale me fuqi 500W, i motorizuar për efektet e zmadhimit dhe fokusimit. Mund të përdoret si dritë mediatike profesionale. Duhet të ketë mundësi për vendosje deri në 6 gobo dhe me kënd nga 7-49˚. |
| **8** | **Platformë skenike (stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 50 m²** | • **Pedana me lartësi të ndryshme**. Panele skenike me përmasa 2 m × 1 m ose 1 m × 1 m me mundësi bashkimi me njëra-tjetrën për të krijuar sipërfaqe të ndryshme skene. Panelet janë me bazë çeliku/alumin dhe këmbë të rregullueshme deri në lartësi 1,5 m nga toka dhe sipërfaqe të |

| | | |
|---|---|---|
| | | gomuar, antirrëshqitëse. Paneli duhet të mbështesë një ngarkesë jo më të vogël se 500 kg/m². |
| 9 | **Platformë skenike (stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 100 m²** | • **Pedana me lartësi të ndryshme**. Panele skenike me përmasa 2 m × 1 m ose 1 m × 1 m me mundësi bashkimi me njëra-tjetrën për të krijuar sipërfaqe të ndryshme skene. Panelet janë me bazë çeliku/alumin dhe këmbë të rregullueshme deri në lartësi 1,5 m nga toka dhe sipërfaqe të gomuar, antirrëshqitëse. Paneli duhet të mbështesë një ngarkesë jo më të vogël se 500 kg/m². |
| 10 | **Platformë skenike (stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 140 m²** | • **Pedana me lartësi të ndryshme**. Panele skenike me përmasa 2 m × 1 m ose 1 m × 1 m me mundësi bashkimi me njëra-tjetrën për të krijuar sipërfaqe të ndryshme skene. Panelet janë me bazë çeliku/alumin dhe këmbë të rregullueshme deri në lartësi 1,5 m nga toka dhe sipërfaqe të gomuar, antirrëshqitëse. Paneli duhet të mbështesë një ngarkesë jo më të vogël se 500 kg/m². |

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen:**

**Afatet e ekzekutimit:**

| Shërbimet | Përshkrimi | Shuma | Vendi i ekzekutimit<br>dhe Afati i ekzekutimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Foni 3 000 W për aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentash, pult fonie, amplifikator, kablla korenti etj) | 23 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |
| 2 | Foni 5 000 W për aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentash, pult fonie, amplifikator, kablla korenti etj) | 17 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3 | Foni 10 000 W, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentash, pult fonie, amplifikator, kablla korenti, foltore, etj) | 6 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor |
| 4 | Ekran LED me rezolucion jo më shumë se 2.6 mm (për ambient të jashtëm) përmasa paneli 50 cm × 100 cm. Jo më pak se 80 m² (duke përfshirë laptop, server video, videoprocesor) | 6 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor |
| 5 | Ekran LED me rezolucion jo më shumë se 2.6 mm (për ambient të jashtëm) përmasa paneli 50 cm × 100 cm. Jo më pak se 150 m² (duke përfshirë laptop, server video, videoprocesor) | 4 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor |
| 6 | Pajisje ndriçimi (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 40 njësi ndriçimi. P.sh.: ndriçues linear, ndriçues wash RGB, ndriçues me kokë të rrotullueshme, pult ndriçimi etj) | 10 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor |
| 7 | Pajisje ndriçimi (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 80 njësi ndriçimi. P.sh.: ndriçues linear, ndriçues wash RGB, ndriçues me kokë të rrotullueshme, pult ndriçimi etj) | 6 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor |
| 8 | Platformë skenike (Stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m² | 7 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor |
| 9 | Platformë skenike (Stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 60 m² | 7 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor |
| 10 | Platformë skenike (Stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 120 m² | 3 | Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor |

**Shtojca 8.**

( *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

## TERMAT E REFERENCES

**Objektivi i përgjithshëm**

Krijimi i një standardi të qëndrueshëm profesional për zhvillimin e aktiviteteve në ambiente të jashtme, duke siguruar infrastrukturën dhe mbështetjen teknike të nevojshme për realizimin e aktiviteteve me cilësi të lartë, rritjen e përvojës së publikut dhe promovimin e hapësirave publike si qendra të aktiviteteve kulturore, sportive dhe rekreative.

**Qëllimi**

Të sigurohet një infrastrukturë teknike profesionale (pajisje dhe shërbime audio, ndriçim, skenë dhe komunikim vizual) që mundëson zhvillimin e aktiviteteve dhe performancave në mënyrë të koordinuar, funksionale dhe artistikisht cilësore, duke përmirësuar prezantimin e tyre, duke mbështetur realizimin e ideve krijuese dhe duke garantuar një përvojë sa më të mirë për publikun dhe interpretuesit.

**LOGJISTIKA DHE KOHA**

A. Vendi i lëvrimit të mallit/i kryerjes së shërbimit: Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
B. Data e fillimit dhe periudha e implementimit të detyrave: 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër

**RAPORTIMI**

Kontraktori do të paraqesë raportet e mëposhtme në formë shkresore në gjuhën shqipe, në dy kopje origjinale: raporte/procesverbale pas realizimit të aktiviteteve.

**GARANCIA**

Kontraktori garanton që pajisjet dhe shërbimet e ofruara janë funksionale, të sigurta dhe në përputhje me specifikimet teknike të kontratës. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve, kontraktori mban përgjegjësi për funksionimin normal të pajisjeve dhe është i detyruar të zëvendësojë ose riparojë

menjëherë çdo pajisje që paraqet defekt ose mosfunksionim, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Gjithashtu, kontraktori garanton disponueshmërinë e stafit teknik gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit, për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit dhe zgjidhjen e menjëhershme të çdo problematike teknike.

**MIRËMBAJTJA**

Kontraktori është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve gjatë gjithë periudhës së ofrimit të shërbimit. Ai duhet të sigurojë që të gjitha pajisjet të jenë në gjendje optimale pune, të kryejë kontrollet e nevojshme para fillimit të çdo aktiviteti dhe të ndërhyjë menjëherë për riparimin ose zëvendësimin e çdo pajisjeje që paraqet defekt, pa ndërprerë zhvillimin normal të aktivitetit.

Të gjitha kostot që lidhen me mirëmbajtjen, riparimin ose zëvendësimin e pajisjeve gjatë zbatimit të kontratës mbulohen nga kontraktori.

**Shtojca 9.**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

1. **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi*;*
dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k*)* zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomikt në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit,* ***sipas shtojcës 10****;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren* ***67,300*** *(gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind) lekë të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**2.1.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese*. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

**2.1.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihen **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

**2.2 Kapaciteti teknik:**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: **673,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë) lekë pa tvsh**. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.2.2** Operatori Ekonomik me anë të një deklarate të sigurojë kryerjen e transportit të të gjitha pajisjeve teknike në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, montimin dhe mirëmbajtjen e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër. Gjithashtu në përfundim të afatit të marrëveshjes kuadër çmontimin e të gjitha paisjeve teknike dhe largimin e tyre nga vendndodhja e përcaktuar nga AK.

**2.2.3** Operatori Ekonomik me anë të një deklarate duhet të sigurojë se disponon staf teknik të kualifikuar dhe me përvojë në organizimin dhe mbështetjen teknike të aktiviteteve të

jashtme, të aftë për instalimin, konfigurimin, operimin, monitorimin dhe çmontimin e pajisjeve audio, ndriçimit, ekraneve LED, skenës dhe pajisjeve të tjera mbështetëse. Stafi i angazhuar duhet të jetë i mjaftueshëm për të garantuar mbarëvajtjen teknike të çdo aktiviteti, si dhe të jetë i disponueshëm për ndërhyrje të menjëhershme gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

**2.2.4** Operatori ekonomik me anë të një deklarate të sigurojë kryerjen e të gjitha detyrave specifike të mëposhtme që sigurojnë mbarëvajtjen e realizimit të shërbimit.

- **a.** Të sigurojë pajisjet teknike profesionale sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe natyrës së çdo aktiviteti.
- **b.** Të realizojë transportin, montimin, konfigurimin, testimin dhe çmontimin e pajisjeve brenda afateve të përcaktuara.
- **c.** Të garantojë funksionimin e pandërprerë të sistemeve audio, ndriçimit, ekraneve LED, skenës dhe pajisjeve të tjera gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- **d.** Të sigurojë praninë e stafit teknik të kualifikuar për operimin dhe monitorimin e pajisjeve, si dhe ndërhyrjen e menjëhershme në rast të problematikave teknike.
- **e.** Të respektojë standardet e sigurisë teknike dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor gjatë gjithë zbatimit të shërbimit.
- **f.** Të dorëzojë shërbimin në përputhje me specifikimet teknike, afatet dhe vendndodhjet e përcaktuara për secilin aktivitet.

**2.2.5** Operatori Ekonomik me anë të një deklarate të sigurojë që pajisjet dhe shërbimet e ofruara janë funksionale, të sigurta dhe në përputhje me specifikimet teknike teknike të listuara si më poshtë. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve, kontraktori mban përgjegjësi për funksionimin normal të pajisjeve dhe është i detyruar të zëvendësojë ose riparojë menjëherë çdo pajisje që paraqet defekt ose mosfunksionim, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

| Nr. | Shërbimi | SPECIFIKIMET TEKNIKE |
|---|---|---|
| 1 | **Foni 10 000 W**, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentesh, mikser fonie, amplifikatorë të fuqishëm, mikrofona pa kabëll, të dorës (handheld), stativë mikrofoni me këmbë të palosshme, kabllo korenti, foltore, etj.) | • **Boks pasiv me mundësi për t'u varur (sistem Line Array):** Boks pasiv 2 rrugësh me dy bokse me përmasa 8" secili për frekuencat e ulëta dhe një Boks me përmasa 3" i kompresuar për frekuencat e larta. Të ketë fuqi të paktën 350 W. Boksi të vijë në formë "Line Array", me të gjithë aksesorët e nevojshëm për ta varur në lartësi dhe për të kombinuar të paktën 12 copë së bashku. Këndi i mbulimit horizontal për frekuencat e larta të ketë të paktën tre mundësi zgjedhje, 110 °, 70 ° dhe 90 °. Elementet e varjes së boksit duhet të lejojnë zgjedhjen e të paktën tetë këndeve të ndryshme kur bokset montohen njëri pas tjetrit. Kasa e boksit duhet të jetë e përbërë nga material drusor dhe të jetë e durueshme ndaj ujit me nivel izolimi të paktën IP55.<br>• **Amplifikator fuqie për foni të varur sistem Line Array.** Amplifikator digjital që të ketë të paktën 4 hyrje sinjali dhe 4 dalje fuqie me të paktën 3300 W RMS për secilën dalje në rezistencën 2.7 ohm dhe të paktën 2600 W RMS në rezistencën 4 ohm. Amplifikatori të mbështesë të paktën dy hyrje sinjali digjitale të standardit AES/EBU. Amplifikatori të ketë të integruar një sistem digjital për menaxhimin e sinjalit audio dhe procesimin e tij. Arkitektura e amplifikatorit të jetë e klasit D dhe të |

| | | |
|---|---|---|
| | | mbështesë frekuencat të paktën nga 20 Hz deri në 20 kHz. Amplifikatori të ketë aftësinë për t'u kontrolluar totalisht në distancë me anë të një program kompjuterik që lejon ndryshimin e parametrave në kohë reale dhe monitorimin e të gjithë parametrave. Procesori i integruar të jetë i tipit 32-bit dhe me frekuencë kampionimi 96 kHz. EQ e integruar të ketë të paktën 8 filtra IR dhe 3 filtra FIR. Të ketë limiter të integruar që ndihmon në mbrojtjen e bokseve. Amplifikatori duhet të ketë një ushqyes universal që lejon të funksionojë në një interval tensioni nga 100 V deri në 240 V.<br>• **Boks aktiv për muzikë dhe monitor skene:** Boks aktiv me dy rrugë, me funksion për monitor skene. Të ketë një amplifikator të integruar me fuqi të paktën 400 W RMS i klasit D. Boksi të ketë një Boks për frekuencat e ulëta me përmasë 10" dhe një Boks për frekuencat e larta me përmasë të paktën 1". Boksi i frekuencave të larta të jetë i montuar në formë koaksiale në atë të frekuencave të ulëta. Hinka e boksit të frekuencave të larta të jetë e rrotullueshme për të krijuar këndet 90x60 ° ose 60x90 ° (Horizontalisht/Vertikalisht). Boksi të ketë të integruar një procesor digjital për ekualizimin e tingullit. Në panelin e kontrollit të ketë mundësinë për të zgjedhur të paktën dy paracaktime të gatshme për performancë Live dhe Playback. Gjithashtu procesori të ketë të integruar një limiter automatik për mbrojtjen e boksit. Brezi i frekuancave që boksi duhet të arrijë të riprodhojë të jetë të paktën 60 Hz deri në 19 kHz. Niveli i presionit të zërit të jetë të paktën 128 dB. Boksi të ketë të paktën një konektor XLR të balancuar për hyrjen e sinjalit dhe një konektor XLR të balancuar për daljen e sinjalit. Konektori për hyrjen e sinjalit të ketë mundësinë që të konfigurohet për hyrje mikrofonike ose Line.<br>• **Boks aktiv me frekuencë të ulët:** Boks aktiv me frekuencë të ulët me amplifikator të klasit D të integruar dhe fuqi minimalisht 1600 W RMS. Përmasat e boksit të jenë 18". Boksi të jetë i përshtatshëm për t'u varur në lartësi (Line Array) dhe të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që sigurojnë montimin e tij në skenë. Brezi i frekuencave që boksi duhet të arrijë të riprodhojë të jetë të paktën 35 Hz deri në 110 Hz. Niveli i presionit të zërit të arrijë të paktën 139 dB. Ushqyesi i amplifikatorit të boksit të jetë i tipit SMPS me tension 100–240 V dhe frekuencë 50 ~ 60Hz.<br>• **Boks pasiv me frekuencë të ulët me mundësi për t'u varur (Line Array):** Subwoofer me dy bokse 18 inç me drejtues ekskursioni të lartë dhe ajrim laminar të optimizuar për të maksimizuar efikasitetin LF - i vendosur në modele të gjithëdrejtimit ose kardioid në konfigurime të grumbulluara ose të fluturuara.<br>• **Boks pasiv me profil të ulët:** Boks pasiv me dy rrugë me një Boks 5" për frekuenca të ulëta si dhe një Boks me përmasa të paktën 1", i kompresuar, për frekuencat e larta. Boksi i frekuencave të larta të jetë i montuar në formë koaksiale me Boksin e frekuencave të ulëta. Kasa e boksit duhet të jetë e përbërë nga material drusor dhe pjesa përpara Boksit të ketë një rrjetë metalike e cila është e trajtuar për të rezistuar hyrjen e grimcave të ngurta, me një nivel izolimi të paktën IP30. Boksi duhet të riprodhojë një brez frekuencash ndërmjet 95 Hz në 20 kHz dhe të ketë një mbulim të paktën 110 °. Boksi të ketë fuqi të paktën 60 W. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • **Pult fonie digjital me jo më pak se 128 kanale.** Mikser audio digjital i pajisur me 3 ekrane, me prekje 12 inç, me mundësi vizibiliteti në dritën e diellit. Mikseri të jetë i pajisur me 24 + 2 faderë të motorizuar. Mikseri duhet të pranojë deri në 192 hyrje dhe 28 dalje. Mikseri të ketë të paktën 5 porta USB 2.0, 2 porta Ethernet dhe 1 portë fibër optike. Të mundësojë regjistrimin e njëkohshëm të deri në 128 kanaleve audio.<br>• **Mikrofon pa kabëll:** Mikrofon pa kabëll që përdoret për fjalime dhe muzikë. Mikrofoni të vijë bashkë me bazën që shërben për marrjen e sinjalit. Baza duhet të mbështesë të paktën 2 mikrofona që funksionojnë njëkohësisht. Sistemi pa kabëll duhet të jetë tërësisht digjital. Mikrofoni duhet të mbështesë inkriptimin e sinjalit të transmetuar me kapacitetin 512-bit. Baza e mikrofonit, veç daljes analoge të sinjalit, duhet të ketë edhe dalje digjitale si DANTE dhe AES EBU. Brezi i frekuencave që duhet të mbështesë mikrofoni: 25 – 20 000 Hz.<br>• **Mikrofona konvencer, jo më pak se 45 copë:** Mikrofona konvencer, të përshtatshëm për përdorim në koncerte dhe interpretim live.<br>• **Mikrofon për instrument:** Mikrofon për instrument frymor që mund të kapet në instrument. Mikrofoni të jetë me kondensator dhe të funksionojë me 9 deri në 52 V. Brezi i frekuencave që duhet të funksionojë: 60 Hz–20 kHz. Polariteti të jetë kardioid.<br>• **Set mikrofonash për bateri:** Seti i mikrofonave për bateri të përbëhet nga të paktën 7 mikrofona që të shërbejnë për të kapur një gamë të gjerë instrumentesh si drum, bas drum, overhead për baterinë dhe mikrofon për amplifikatorë kitare.<br>• **Mikrofon foltoreje:** Mikrofon për foltore me gjatësi 40 cm. Kapsula e mikrofonit të jetë e çmontueshme për të mundësuar instalimin e disa kapsulave të ndryshme. Mikrofoni të shoqërohet me kapsulë kardioide dhe superkardioide.<br>• **Mikrofon për prezantues:** Mikrofoni për prezantues është i montueshëm në pjesën e kokës. Të ketë të paktën dy kapje që mbështeten në vesh. Mikrofoni dhe kapsula të kenë ngjyrë bezhë të hapur. Polariteti i kapsulës të jetë superkardioid. Mikrofoni të shoqërohet me një transmetues valor që montohet në trup dhe një marrës valor që shërben për marrjen e sinjalit të transmetuar.<br>• **Përforcues sinjali audio:** Përforcuesi i sinjalit audio të ketë të paktën dy hyrje jack ¼” dhe një hyrje XLR. Përforcuesi duhet të stabilizojë dhe balancojë sinjalin audio që vjen direkt nga instrumentet muzikore.<br>• **Shpërndarës sinjali audio:** Shpërndarës sinjali audio digjital me të paktën 32 kanale hyrëse dhe 16 kanale dalëse. Të ketë të paktën 2 dalje digjitale AES/EBU me konektorë XLR të balancuar. Secili kanal hyrës, me konektorë XLR të balancuar, të ketë opsion për aktivizim fuqie +48V për mikrofonat që kërkojnë “phantom power”.<br>• **Set pajisjesh për DJ.** Set pajisjesh profesionale për performancë DJ, i përbërë nga pajisje riprodhimi audio dhe mikser DJ.<br>• **Foltore e branduar.** Foltore transparente, e cila të ofron mundësinë e brandimit sipas dizajnit të Autoritetit Kontraktor, e përshtatshme për fjalime dhe aktivitete të kategorive të ndryshme. |
| **2** | **Foni 5000 W**, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentesh, | • **Boks aktiv për muzikë:** Boks me dy rrugë aktiv me frekuencë të ulët 15’’ dhe frekuencë të lartë 1.4” me fuqi 900 W, me amplifikator të integruar të klasit D me fuqi minimalisht 900 W RMS. Të ketë mundësi kontrolli me RDNet me program kompjuterik për analizën e |

| | | |
|---|---|---|
| | mikser fonie, mikrofona pa kabëll, të dorës (handheld), stative mikrofoni me këmbë të palosshme amplifikator, kabllo korenti, etj) | frekuencave dhe optimizimin e sistemit në distancë.<br>• **Boks aktiv për fjalim:** Boks me dy rrugë me Boks 10" dhe frekuencë të lartë 1" me amplifikator të integruar. Boksi të ketë fuqi të paktën 500 W dhe nivel presioni zanor deri në të paktën 122 dB.<br>• **Pult fonie digjital me 32 kanale:** Pult fonie digjital. Pulti duhet të ketë të paktën 32 hyrje mono, si dhe 32 faderë të motorizuar. Pulti të ketë 32 hyrje dhe 16 dalje analoge. Pulti duhet të mbështesë protokollin Dante dhe të menaxhohet nëpërmjet programit Dante Controller. Pulti të shoqërohet me një "stagebox" (pajisje për ndërlidhje sinjali) i cili mundëson shtimin e 32 hyrjeve dhe 16 daljeve. Pulti të ketë të integruar një ekran digjital me anë të të cilit të kontrollohen dhe të rregullohen parametra të ndryshëm. Pulti të krijojë mundësinë që të kryejë regjistrim multi-track me 32 kanale. Pulti duhet të krijojë mundësi për procesim zëri në çdo hyrje dhe dalje.<br>• **Mikrofon vokali me kabëll:** Mikrofon vokali dinamik me kabëll. Polariteti superkardioid. Brezi i frekuencave 50 Hz – 16 kHz. Mikrofoni të jetë i përshtatshëm për t'u përdorur në koncerte dhe këngëtarë live.<br>• **Set pajisjesh për DJ.** Set pajisjesh profesionale për performancë DJ, i përbërë nga pajisje riprodhimi audio dhe mikser DJ. |
| **3** | **Foni 3000 W**, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentesh, pult fonie, amplifikator, kabllo korenti, etj) | • **Boks aktiv për muzikë:** Boks me dy rrugë aktiv me frekuencë të ulët 15'' dhe frekuencë të lartë 1.4" me fuqi 900 W, me amplifikator të integruar të klasit D me fuqi minimalisht 900 W RMS. Të ketë mundësi kontrolli me RDNet me program kompjuterik për analizën e frekuencave dhe optimizimin e sistemit në distancë.<br>• **Boks aktiv për fjalim:** Boks me dy rrugë me Boks 10", dhe frekuencë të lartë 1" me amplifikator të integruar. Boksi të ketë fuqi të paktën 500 W dhe nivel presioni zanor deri në të paktën 122 dB.<br>• **Pult fonie digjital me 16 kanale:** Pult fonie digjital. Pulti duhet të ketë të paktën 16 hyrje mono, si dhe 16 faderë të motorizuar. Pulti të ketë 16 hyrje dhe 8 dalje analoge. Pulti duhet të mbështesë protokollin Dante dhe të menaxhohet nëpërmjet programit Dante Controller. Pulti të shoqërohet me një "stagebox" (pajisje për ndërlidhje sinjali) i cili mundëson shtimin e 16 hyrjeve dhe 8 daljeve. Pulti të ketë të integruar një ekran digjital me anë të të cilit të kontrollohen dhe të rregullohen parametra të ndryshëm. Pulti të krijojë mundësinë që të kryejë regjistrim multi-track me 16 kanale. Pulti duhet të krijojë mundësi për procesim zëri në çdo hyrje dhe dalje.<br>• **Mikrofon vokali me kabëll:** Mikrofon vokali dinamik me kabëll. Polariteti superkardioid. Brezi i frekuencave 50 Hz – 16 kHz. Mikrofoni të jetë i përshtatshëm për t'u përdorur në koncerte dhe këngëtarë live.<br>• **Set pajisjesh për DJ.** Set pajisjesh profesionale për performancë DJ, i përbërë nga pajisje riprodhimi audio dhe mikser DJ. |
| **4** | **Ekran LED për ambient të jashtëm – jo më pak se 80 m²** me hap pikseli (pixel pitch) jo më të madh se 1,9 mm (duke përfshirë laptop, server video, videoprocesor, strukturë mbajtëse për ekranin LED). | • **Ekrani LED me hap pikseli (pixel pitch) jo më të madh se 1,9 mm për ambient të jashtëm.** Përmasat e një paneli LED janë 50 cm × 100 cm. Jo më pak se 80 m². Ekrani LED është i përshtatshëm për video dhe imazhe të formateve të ndryshme.<br>• **Strukturë mbajtëse për ekranin LED**: Strukturë alumini për mbajtje peshe. Struktura të jetë lehtësisht e montueshme dhe e çmontueshme në përmasa të rregulluara sipas kërkesave të ekranit LED. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • **Videoprocesor: procesor** video për përdorimin e ekranit LED. Procesori i videos duhet të ketë mundësinë për hyrje DVI, VGA dhe USB.<br>• **Server video.** Media server, të ketë të paktën 20 shtresa Full HD 1080p, hyrje video të paktën 1 HD-SDI, 1 HDMI dhe 2 VGA. Dalje video të paktën 2 DVI, 1 HDMI dhe 2 VGA.<br>• **Laptop:** Laptop video për të bërë të mundur shfaqjen e imazheve video në ekranin LED. |
| **5** | **Ekran LED për ambient të jashtëm – jo më pak 150 m²** me hap pikseli (pixel pitch) jo më të madh se 1,9 mm (duke përfshirë laptop, server video, videoprocesor, strukturë mbajtëse për ekranin LED). | • **Ekrani LED me hap pikseli (pixel pitch) jo më të madh se 1,9 mm për ambient të jashtëm.** Përmasat e një paneli LED janë 50 cm × 100 cm. Jo më pak se 150 m². Ekrani LED është i përshtatshëm për video dhe imazhe të formateve të ndryshme.<br>• **Strukturë mbajtëse për ekranin LED**: Strukturë alumini për mbajtje peshe. Struktura të jetë lehtësisht e montueshme dhe e çmontueshme në përmasa të rregulluara sipas kërkesave të ekranit LED.<br>• **Videoprocesor: procesor** video për përdorimin e ekranit LED. Procesori i videos duhet të ketë mundësinë për hyrje DVI, VGA dhe USB.<br>• **Server video.** Media server, të ketë të paktën 20 shtresa Full HD 1080p, hyrje video të paktën 1 HD-SDI, 1 HDMI dhe 2 VGA. Dalje video të paktën 2 DVI, 1 HDMI dhe 2 VGA.<br>**Laptop:** Laptop video për të bërë të mundur shfaqjen e imazheve video në ekranin LED. |
| **6** | **Pajisje ndriçimi jo më pak se 70 njësi** (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 70 njësi ndriçimi. P.sh.: ndriçues linear, ndriçues wash RGB, ndriçues me kokë të rrotullueshme, pult ndriçimi etj) | • **Konfigurimi duhet të përmbajë jo më pak se 70 njësi funksionale ndriçimi në total, të përzgjedhura nga kategoritë e mëposhtme sipas kërkesave të aktivitetit. Robot Spot:** Roboti të jetë me llambë të paktën 250 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Spot, por të mos jetë i limituar edhe për përdorim si Beam dhe Wash. Këndet e zoomit që duhet të mbështesë: 2.2 – 24° për Beam, 2.5 – 24° për Spot dhe 15 – 45° për wash. Të ketë të paktën 8 “gobo” të motorizuara dhe 12 gobo statike. Të ketë një prizëm linear me të paktën 4 faqe dhe një prizëm me 8 faqe që rrotullohet. Të ketë të paktën 10 ngjyra të ndryshme, përfshi CTO, CTB, UV. Fokusi të jetë i motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br>• **Robot Beam:** Roboti të jetë me llambë të paktën 180 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Beam. Këndi i lentes të jetë 1° - 3.8°. Të ketë të paktën 17 gobo. Të ketë të paktën një prizëm me 8 faqe. Të ketë frost, zoom të motorizuar, fokus të motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br>• **Robot wash:** Roboti të jetë me LED RGBW me fuqi të paktën 120 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Wash. Intensiteti i dritës të jetë të paktën 2000 lumen. Roboti të ketë zoom të motorizuar me kënde 10°–60°. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br>• **Ndriçues wash RGB:** Ndriçues wash jo i motorizuar dhe të ketë të paktën 4 LED RGB me nga 30 W secili. Këndi i dritës të jetë të paktën 60°. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX.<br>• **Dritë e bardhë mediatike.** Ndriçues i bardhë mediatik me fuqi 300 W me LED. Ndriçuesi të krijojë mundësinë për ndriçim të bardhë të ngrohtë |

| | | |
|---|---|---|
| | | dhe të ftohtë nga 3 000 K–8 000 K. Këndi i ndriçimit 15°-50°. Ndriçuesi të jetë i përshtatshëm për një ndriçim sa më funksional për kamera me cilësi të lartë.<br>• **Pult ndriçimi**. Mikser ndriçimi me 4 universe (4 × DMX) me mundësi lidhjeje të një monitori nëpërmjet hyrjes VGA ose DVI. Mikseri të ketë aftësinë të mbajë deri në 32 universa DMX dhe deri në 8192 parametra të ndryshëm. Mikseri të ketë mundësinë e dy llambave për të punuar edhe në errësirë.<br>• **Dritë skenike (për folësin).** Ndriçues skenik RGBW me llambë halogjene 575 W. Ndriçuesi është i përshtatshëm për të fokusuar në skenë folësin apo këdo që është në skenë. Këndi i ndriçimit është 13° - 19°.<br>• **Blitz për efekte speciale.** Ndriçues blitz me llambë LED-Xenon 3000 W. Ndriçuesi është i përshtatshëm për përdorim në koncerte për të krijuar efektin e blitzit. Ndriçuesi kontrollohet nga protokolli DMX. Temperatura e dritës është 5700 K. Ndriçuesi shoqërohet me të gjithë aksesorët përkatës për t'u instaluar.<br>• **Tym skenik.** Pajisje tymi skenik. Pajisja krijon mundësinë që lëngun përkatës ta kthejë në efekt mjegull. Përdoret për efekte skenike, gjithashtu, për të bërë të dukshme edhe efektet e ndriçimit. Pajisja kontrollohet nga protokolli DMX.<br>• **Robot WashBeamLED me fuqi llambë led mbi 700 W**. Roboti të jetë me fuqi llambë mbi 700W si edhe të përbëhet nga 18 llamba LED me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë gamë zmadhimi 4° - 50°. Roboti të përbëhet nga 4 unaza LED të kontrollueshme individualisht.<br>• **Robot BeamLED me fuqi llambë led mbi 450 W.** Roboti të jetë me fuqi llambë minimalisht 450 W si edhe të përbëhet nga 12 llamba LED me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë gamë zmadhimi 4° - 60°. Duhet të ketë efekt elektronik strobe me shpejtësi të ndryshueshme deri në 20 Hz. Gama e lëvizjes së Pan të jetë 450°. Konsumi i energjisë të jetë maksimalisht 450 W në 230 V / 50 Hz.<br>• **Robot WASH me fuqi llambë 1200 W**. Roboti të ketë Llambë shkarkimi 1200W. Të ketë 2 × 5 gobo rrotulluese të indeksueshme. Të mundësojë efekt strobe 2 - 10 Hz si edhe të ketë efekt zoom dhe fokus të motorizuar. Gama e lëvizjes së Pan dhe Tilt të jetë 540°/267°. Pesha e pajisjes të jetë jo më pak se 40 kg si edhe të mundësojë fokusim nga 2 m deri në pafundësi.<br>• **Robot Spot me fuqi llambë 400 W**. Roboti të ketë llambë me fuqi minimale 400 W si edhe të ketë një zmadhim që varion nga 4° në 50° (raporti 1:12 ). Roboti të ketë një fokusim elektronik për një rreze drite të përkryer të mprehtë përgjatë gjithë gjatësisë së saj si edhe të ketë 15 filtra të veçantë me ngjyra. Pesha e robotit të jetë jo më shumë se 35 kg.<br>• **Robot Hybrid Spot me fuqi llambë mbi 400 W**. Roboti të ketë një llambë minimalisht 470 W si edhe 7 500 K. Diametri i lentes së robotit të jetë 150 mm. Roboti të jetë i pajisur me 9 gobo të rrotullueshme dhe 14 gobo statike. Roboti të mos konsumojë më shumë se 690 W.<br>• **RGB Verbuese/RGB Blinder.** Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga mbi 1800 llamba LED RGBW me intensitet drite 5700K. Hapja e dritës maksimale të jetë 110°. |

| | | |
|---|---|---|
| | | Temperatura të variojë nga 2 000 K–10 000 K. Konsumi maksimal i robotit të mos jetë më shumë se 470W.<br>• **Verbues/Blinder.** Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga 4 llamba 650 W secila. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX, i përshtatshëm për t'u vendosur në skena dhe ambiente të ndryshme. Ndriçuesi të shoqërohet me të gjithë aksesorët përkatës për t'u instaluar.<br>• **Dritë Skenike 1,7 kW e automatizuar.** Robot spot me fuqi maksimale 1 700 W. Të jetë i pajisur me llambë 6 000 K, me kapacitet zmadhimi dhe zvogëlimi të dritës nga 5˚-55˚. Niveli i ndriçimit të jetë 200 000 lx në 5 metra distancë.<br>• **Robot Profile.** Robot i pajisur me llambë LED multispektrale me fuqi 500W, i motorizuar për efektet e zmadhimit dhe fokusimit. Mund të përdoret si dritë mediatike profesionale. Duhet të ketë mundësi për vendosje deri në 6 gobo dhe me kënd nga 7-49˚. |
| **7** | **Pajisje ndriçimi jo më pak se 140 njësi** (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 140 njësi ndriçimi. P.sh.: ndriçues linear, ndriçues wash RGB, ndriçues me kokë të rrotullueshme, pult ndriçimi etj) | • **Konfigurimi duhet të përmbajë jo më pak se 140 njësi funksionale ndriçimi në total, të përzgjedhura nga kategoritë e mëposhtme sipas kërkesave të aktivitetit. Robot Spot:** Roboti të jetë me llambë të paktën 250 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Spot, por të mos jetë i limituar edhe për përdorim si Beam dhe Wash. Këndet e zoomit që duhet të mbështesë: 2.2 – 24° për Beam, 2.5 – 24° për Spot dhe 15 – 45° për wash. Të ketë të paktën 8 "gobo" të motorizuara dhe 12 gobo statike. Të ketë një prizëm linear me të paktën 4 faqe dhe një prizëm me 8 faqe që rrotullohet. Të ketë të paktën 10 ngjyra të ndryshme, përfshi CTO, CTB, UV. Fokusi të jetë i motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br>• **Robot Beam:** Roboti të jetë me llambë të paktën 180 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Beam. Këndi i lentes të jetë 1° - 3.8°. Të ketë të paktën 17 gobo. Të ketë të paktën një prizëm me 8 faqe. Të ketë frost, zoom të motorizuar, fokus të motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br>• **Robot wash:** Roboti të jetë me LED RGBW me fuqi të paktën 120 W. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Wash. Intensiteti i dritës të jetë të paktën 2000 lumen. Roboti të ketë zoom të motorizuar me kënde 10°–60°. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesorët e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë.<br>• **Ndriçues wash RGB:** Ndriçues wash jo i motorizuar dhe të ketë të paktën 4 LED RGB me nga 30 W secili. Këndi i dritës të jetë të paktën 60°. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX.<br>• **Dritë e bardhë mediatike.** Ndriçues i bardhë mediatik me fuqi 300 W me LED. Ndriçuesi të krijojë mundësinë për ndriçim të bardhë të ngrohtë dhe të ftohtë nga 3 000 K–8 000 K. Këndi i ndriçimit 15°-50°. Ndriçuesi të jetë i përshtatshëm për një ndriçim sa më funksional për kamera me cilësi të lartë.<br>• **Pult ndriçimi**. Mikser ndriçimi me 4 universe (4 × DMX) me mundësi lidhjeje të një monitori nëpërmjet hyrjes VGA ose DVI. Mikseri të ketë |

| | | |
|---|---|---|
| | | aftësinë të mbajë deri në 32 universa DMX dhe deri në 8192 parametra të ndryshëm. Mikseri të ketë mundësinë e dy llambave për të punuar edhe në errësirë.<br>• **Dritë skenike (për folësin).** Ndriçues skenik RGBW me llambë halogjene 575 W. Ndriçuesi është i përshtatshëm për të fokusuar në skenë folësin apo këdo që është në skenë. Këndi i ndriçimit është 13° - 19°.<br>• **Blitz për efekte speciale.** Ndriçues blitz me llambë LED-Xenon 3000 W. Ndriçuesi është i përshtatshëm për përdorim në koncerte për të krijuar efektin e blitzit. Ndriçuesi kontrollohet nga protokolli DMX. Temperatura e dritës është 5700 K. Ndriçuesi shoqërohet me të gjithë aksesorët përkatës për t'u instaluar.<br>• **Tym skenik.** Pajisje tymi skenik. Pajisja krijon mundësinë që lëngun përkatës ta kthejë në efekt mjegull. Përdoret për efekte skenike, gjithashtu, për të bërë të dukshme edhe efektet e ndriçimit. Pajisja kontrollohet nga protokolli DMX.<br>• **Robot WashBeamLED me fuqi llambë led mbi 700 W**. Roboti të jetë me fuqi llambë mbi 700W si edhe të përbëhet nga 18 llamba LED me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë gamë zmadhimi 4° - 50°. Roboti të përbëhet nga 4 unaza LED të kontrollueshme individualisht.<br>• **Robot BeamLED me fuqi llambë led mbi 450 W.** Roboti të jetë me fuqi llambë minimalisht 450 W si edhe të përbëhet nga 12 llamba LED me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë gamë zmadhimi 4° - 60°. Duhet të ketë efekt elektronik strobe me shpejtësi të ndryshueshme deri në 20 Hz. Gama e lëvizjes së Pan të jetë 450°. Konsumi i energjisë të jetë maksimalisht 450 W në 230 V / 50 Hz.<br>• **Robot WASH me fuqi llambë 1200 W**. Roboti të ketë Llambë shkarkimi 1200W. Të ketë 2 × 5 gobo rrotulluese të indeksueshme. Të mundësojë efekt strobe 2 - 10 Hz si edhe të ketë efekt zoom dhe fokus të motorizuar. Gama e lëvizjes së Pan dhe Tilt të jetë 540°/267°. Pesha e pajisjes të jetë jo më pak se 40 kg si edhe të mundësojë fokusim nga 2 m deri në pafundësi.<br>• **Robot Spot me fuqi llambë 400 W**. Roboti të ketë llambë me fuqi minimale 400 W si edhe të ketë një zmadhim që varion nga 4° në 50° (raporti 1:12 ). Roboti të ketë një fokusim elektronik për një rreze drite të përkryer të mprehtë përgjatë gjithë gjatësisë së saj si edhe të ketë 15 filtra të veçantë me ngjyra. Pesha e robotit të jetë jo më shumë se 35 kg.<br>• **Robot Hybrid Spot me fuqi llambë mbi 400 W**. Roboti të ketë një llambë minimalisht 470 W si edhe 7 500 K. Diametri i lentes së robotit të jetë 150 mm. Roboti të jetë i pajisur me 9 gobo të rrotullueshme dhe 14 gobo statike. Roboti të mos konsumojë më shumë se 690 W.<br>• **RGB Verbuese/RGB Blinder.** Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga mbi 1800 llamba LED RGBW me intensitet drite 5700K. Hapja e dritës maksimale të jetë 110°. Temperatura të variojë nga 2 000 K–10 000 K. Konsumi maksimal i robotit të mos jetë më shumë se 470W.<br>• **Verbues/Blinder.** Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga 4 llamba 650 W secila. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX, i përshtatshëm për t'u vendosur në skena dhe ambiente |

| | | |
|---|---|---|
| | | të ndryshme. Ndriçuesi të shoqërohet me të gjithë aksesorët përkatës për t’u instaluar.<br>• **Dritë Skenike 1,7 kW e automatizuar.** Robot spot me fuqi maksimale 1 700 W. Të jetë i pajisur me llambë 6 000 K, me kapacitet zmadhimi dhe zvogëlimi të dritës nga 5˚-55˚. Niveli i ndriçimit të jetë 200 000 lx në 5 metra distancë.<br>• **Robot Profile.** Robot i pajisur me llambë LED multispektrale me fuqi 500W, i motorizuar për efektet e zmadhimit dhe fokusimit. Mund të përdoret si dritë mediatike profesionale. Duhet të ketë mundësi për vendosje deri në 6 gobo dhe me kënd nga 7-49˚. |
| **8** | **Platformë skenike (stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 50 m²** | • **Pedana me lartësi të ndryshme**. Panele skenike me përmasa 2 m × 1 m ose 1 m × 1 m me mundësi bashkimi me njëra-tjetrën për të krijuar sipërfaqe të ndryshme skene. Panelet janë me bazë çeliku/alumin dhe këmbë të rregullueshme deri në lartësi 1,5 m nga toka dhe sipërfaqe të gomuar, antirrëshqitëse. Paneli duhet të mbështesë një ngarkesë jo më të vogël se 500 kg/m². |
| **9** | **Platformë skenike (stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 100 m²** | • **Pedana me lartësi të ndryshme**. Panele skenike me përmasa 2 m × 1 m ose 1 m × 1 m me mundësi bashkimi me njëra-tjetrën për të krijuar sipërfaqe të ndryshme skene. Panelet janë me bazë çeliku/alumin dhe këmbë të rregullueshme deri në lartësi 1,5 m nga toka dhe sipërfaqe të gomuar, antirrëshqitëse. Paneli duhet të mbështesë një ngarkesë jo më të vogël se 500 kg/m². |
| **10** | **Platformë skenike (stage) me sipërfaqe jo më të vogël se 140 m²** | • **Pedana me lartësi të ndryshme**. Panele skenike me përmasa 2 m × 1 m ose 1 m × 1 m me mundësi bashkimi me njëra-tjetrën për të krijuar sipërfaqe të ndryshme skene. Panelet janë me bazë çeliku/alumin dhe këmbë të rregullueshme deri në lartësi 1,5 m nga toka dhe sipërfaqe të gomuar, antirrëshqitëse. Paneli duhet të mbështesë një ngarkesë jo më të vogël se 500 kg/m². |

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 10.**

## FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________ të operatorit ekonomik _______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ------------------------------------------------- |
| Numri NIPT/et: | ---------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ----------------------------------------------------<br>-- |
| Përfaqësuesi (emri): | --------------------------------------------- |
| Telefoni: | ----------------------------------------------------<br>- |
| E-mail: | ----------------------------------------------------<br>------ |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br>• **Informacione për nënkontraktorin** |
|---|

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

## A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

| **Deklarata** |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________ |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br>______________________________<br>______________________________<br>etj. |

| |
|---|
| nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _______________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _______________________________________________ |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _______________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _______________________________________________ |
| Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.<br>*Sqarime nëse vlerësohet nevojshme*_________________________________________________ |
| |
| Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*<br>__________________________________________________ |
| Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.<br>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të |

| |
|---|
| përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________________________ |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________________________ |

**B: DEKLARATA "Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura"**

| |
|---|
| Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:<br><br>Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.<br><br>Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër[7].<br><br>Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:<br><br>çmimet;<br>metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;<br>qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,<br>paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.<br><br>Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.<br><br>Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj. |

**C: DEKLARATA "Mbi Konfliktin e Interesit"**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br><br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. |

[7] *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.
- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit**.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

## D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: |

- Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*
____________________________________________________

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË "Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës"**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ] |
| | |

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. | <u>Punonjës</u><br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve:<br><br>______________________<br><br>Profili i punonjësve<br><br>______________________<br><br><u>Makineri e mjete</u> |

| | |
|---|---|
| | Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: |
| **Emri, Mbiemri____________**<br><br>**Firma____________**<br><br>**Vula_________________**<br><br>**Data e dorëzimit të deklaratës ________________** | |

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**

- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**

- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**

- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara. Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

**Shtojca 11.**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**Formulari i Njoftimit të Skualifikimit[8]**

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/ Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

Nëse mendoni se autoriteti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit te njoftimit te fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**

[8] *Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore*

**Shtojca 12.**

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

**Data**

**Drejtuar:**

**Operatorit Ekonomik (OE)** ☐____**ose**

*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** ☐

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** ☐ ***JO*** ☐

*Nëse po, të jepen dhënat*________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** ☐ **JO** ☐

*Nëse po, të jepen dhënat:* ______________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës:_______________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:________________

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*______

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

Vlera ___________________________________________________________________________________

(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera ___________________________________________________________________________________

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.___________________________________________________________________________________

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1.__________________________________ ___________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ______________ ____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

* * *

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej _____________ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

**Shtojca 13.**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

*[Data]*

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE)** □_____**ose**

*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** □

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** □ ***JO*** □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** □ **JO** □

*Nëse po, të jepen dhënat:* ______________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës:_______________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: ___________________________

[9]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit *[Data] [Numri]*___________________________

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

[9] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP*

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1.______________ ________________ ________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t* Vlera *(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ____________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.____________________ _________ ____________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* Vlera *(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ____________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.__________________________________________________________________________

____

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.________________________________ _______________ _____________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ____________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.________________________________ ____________________ ________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT*-it arsyet

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

<u>*Nëse po,*</u> *të jepen dhënat* ____________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO □ JO□

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

**[Titullari i Autoritetit Kontraktor]**

**Shtojca 14.**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR , PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

**Data**

**Drejtuar:**

**Operatorit Ekonomik (OE)** □ ____ **ose**
*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** □
*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** □ ***JO*** □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** □ **JO** □

*Nëse po, të jepen dhënat:* ________________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

* * *

Tipi i Kontratës:_______________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:________________

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*______

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1.__________________________________ ______________________________

______________________________________________________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave________________________________________________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ___________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.______________________________ ___________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave________________________________________________________________

*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ___________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.__________________________

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1.______________________________ _____________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ___________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.______________________________ ________________ ______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ___________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i suksesshëm:

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave ______________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave ______________________________

*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

Etj.______________________________

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

**Shtojca 15.**

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

*[Data]*

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE)** □ **ose**

*[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]*

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** □

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** □ ***JO*** □

*Nëse po, të jepen dhënat* ________________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** □ **JO** □

*Nëse po, të jepen dhënat:* ______________________________________

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës:_______________

Lloji i Procedurës së prokurimit:__________

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit (___________________________

[10]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit, *[Data] [Numri]*___________________________

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

[10] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP*

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave _______________________________________________________
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________________
*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave _____________________________________
OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________________
*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Etj.___________________________

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.__________________________________ ________________ ____________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________________
*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

2._________________________________ _____________ ______________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

OE/BOE me nënkontraktor

PO □ JO □

*Nëse po, të jepen dhënat* ______________________________________
*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave____________________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ______________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

2.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave ____________________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ______________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra _______________

Etj.______________________________

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek [*emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor* ] brenda ____________ ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☐

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

**[Titullari i Autoritetit Kontraktor]**

**Shtojca 16.**

*(Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

Emri__________________

Adresa__________________

Tel/Faks__________________

E-mail_________________

Ueb-faqe__________________________________________________________

**2. Lloji i procedurës: ______________________________________________________**

**3. Numri i Referencës se procedures/lotit:**

**4. Objekti i Kontratës _________________________________________________________**

**5. Fondi Limit________________________________________________________________**

**6. Arsyet e Anulimit:**

☐*në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;*
☐*në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*
☐*konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;*
☐*për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;*
☐*kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në LPP;*
☐*kur titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas parashikimeve në nenin 19/4 të LPP.*

**7. Informacion shtesë**

________________________________________________________________________________

__________________________________________________________________

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

## **Seksioni III** Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Ky Seksion përmban :

Shtojca 17: Kushtet e Përgjithshme

Shtojca 18: Kushtet e Veçanta të Kontratës

Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 20: Draftmarrëveshja kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 21: Draftmarrëveshja kuadër ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

## Shtojca 17

## Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

### Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

### 1.1 Përkufizimet

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

### 1.1.1 Kontrata

**1.1.1.1** "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

**1.1.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

**1.1.1.3** "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

**1.1.1.4** "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

**1.1.1.5** "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.

**1.1.1.6** "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

**1.1.1.7** "Termat e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**1.1.1.8** "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

**1.1.1.9** "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

**1.1.1.10** "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

**1.1.1.11** "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### 1.1.2 Palët e Kontratës

**1.1.2.1** "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

**1.1.2.2** “Blerës” do të thotë Autoriteti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.

**1.1.2.3** "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimine Shërbimeve objekt kontrate.

**1.1.2.4** "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

**1.1.3 Llogaritja e afateve**

**1.1.3.1** "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

**1.1.4 Shërbimet**

**1.1.4.1** "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

**1.1.5 Përkufizime të tjera**

**1.1.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

**1.1.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 “Forca Madhore”.

**1.1.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 “Sigurimi i Kontratës”.

**1.1.5.4** “Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

**1.1.5.5** “E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës..

**1.1.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.

**1.1.5.7** “Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.

**1.1.5.8** "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

**1.2 Interpretimi**

**1.2.1** Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;

(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;

(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord” ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;

(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

**1.2.2 Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

### 1.2.3 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

### 1.2.4 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

### 1.3 Komunikimet

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

Dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

### 1.4 Ligji dhe gjuha

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

### 1.5 Prioriteti i Dokumenteve

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

### 1.6 Hartimi i Kontratës

**1.6.1** Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

**1.6.2** Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

## 1.7 E drejta e autorit

**1.7.1** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

## 1.8 Detaje Konfidenciale

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

## 1.9 Pajtueshmëria me ligjet

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) te ketij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

## 1.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

**1.11 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) ) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2 Praktikat e Ndaluara**

**2.1** Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

**2.2** Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3 Njoftimet**

**3.1** Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

**3.2** Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4 Objekti i Furnizimit**

**4.1** Shërbimet që do të furnizohen duhet të jenë sipas termave të referencës dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**4.2** Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5 Dorëzimi**

**5.1** Dorëzimi i Shërbimeve do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 6 Përgjegjësitë e Furnizuesit**

**6.1** Furnizuesi do të jetë përgjegjës për kryerjen e e të gjitha Shërbimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Furnizuesit**

**7.1** Furnizuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuara në përgjithësi.

7.2 Furnizuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Blerësit, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Blerësit.

**Neni 8** **Detyrimet e Veçanta të Furnizuesit**

**8.1** Furnizuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës.

**8.2** Furnizuesi duhet t'i paraqesë Blerësit të gjitha shërbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

**8.3** Furnizuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Çmimi i Kontratës**

**9.1** Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 19.

**Neni 10 Kushtet e Pagesës**

**10.1** Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.

Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

**10.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

**10.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

**10.4** Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 11 Sigurimi i Kontratës**

**11.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.

**11.2** Në përputhje me Nenin 11.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.

**11.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.

**11.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 12 Nënkontraktimi**

**12.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.

**12.2** Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për shërbimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit.

**12.3** Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 13 Specifikime dhe Skicime**

**13.1** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

**13.2** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 14 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

**14.1** Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

**14.2** Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shrbimeve që po sigurohen.

**Neni 15 Dëmet e likujduara**

**15.1** Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

## Neni 16 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

16.1 Furnizuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Blerësi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Furnizuesit.

16.2 Furnizuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Blerësi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Blerësi është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

16.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

16.4 Furnizuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Blerësit.

## Neni 17 Zhdëmtimi i Patentës

17.1 Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) ofrimit të shërbimeve nga Furnizuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;

dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.

Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

17.2 Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 15.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

17.3 Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

## Neni 18 Kufizimi i Përgjegjësisë

**18.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

## Neni 19 Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë

**19.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

## Neni 20 Forca madhore

**20.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

**20.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

**20.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

## Neni 21 Modifikimi i Kontratës

**21.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

**21.2** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

21.3 Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 22 Zgjatja e afatit**

22.1 Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

22.2 Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 20, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

**Neni 23 Ndërprerja e Kontratës**

**23.1 Njoftim për të korrigjuar**

Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

**23.2 Ndërprerja për mospërmbushje**

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

(i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 23.1 të këtij neni;

(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 22; ose

(iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

**23.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

**23.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 24 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**24.1** Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

**24.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

**Shtojca 18.**

**Kushtet e Veçanta të Kontratës**

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

**Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme**

**1.1** Blerësi është: ***[vendos emrin e Blerësit ]***

Adresa: ______________________________________________

Telefoni: ______________________________________________

Numri i faksit: ______________________________________________

E-mail: ______________________________________________

**1.2** Furnizuesi është: ***[vendos emrin e Furnizuesit]***

Adresa: ______________________________________________

Telefoni: ______________________________________________

Numri i faksit: ______________________________________________

E-mail: ______________________________________________

*Të dhënat e mësipërme duhet të jenë të sakta për qëllime të komunikimeve gjatë zbatimit të kontratës*.

**1.3** Gjuha për komunikimet është ***[specifiko gjuhën për komunikime]****:*

Gjuha është: ***[specifiko gjuhën]***

**Neni 2 Sigurimi i Kontratës**

**2.1** Sigurimi i Kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së saj)* duhet të ofrohet nga Furnizuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**2.2** Monedha do të jetë: ***[*specifikoni monedhën*]***

**2.3** Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Furnizuesit sipas formularit të mëposhtëm

**2.4** Nëse parashikohet një ulje periodike e sigurimit të Kontratës, ajo kryhet si më poshtë: ______________________________________________

*Nëse nuk plotësohet, sigurimi mbetet i pandryshuar.*

**Neni 3 Vendndodhja e Shërbimeve**

**3.1** Shërbimet do të kryhen në: ________________________

**Neni 4 Informacion që duhet dhënë nga Blerësi**

**4.1** Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Blerësi duhet t'i japë Furnizuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

**5.1** **Neni 5 Kërkesat e Raportimit**

Gjatë zgjatjes së kontratës, Furnizuesi duhet të sigurojë raporte për Blerësin sipas formularit të mëposhtëm: ______________________________________________________________________

**Neni 6 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

**6.1** Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: ______________________________________________________________________

**Neni 7 Çmimi i Kontratës**

**Çmimi i Kontratës është: __________________________ me tvsh.**

**Neni 8 Kushtet e pagesës**

**8.1** (a) Pagesa për Shërbimet do të bëhet brenda _________ ditëve nga data e pranimit të Shërbimeve ose nga data e marrjes së kërkesës për pagesë me shkrim, pavarësisht nga dita e ardhjes. Nëse nuk specifikohet, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

(b) Pagesa do të bëhet në monedhën ______. Nëse lihet e paplotësuar, pagesa do të bëhet në monedhën Shqiptare.

**8.2** Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit të detajuar në mënyrë të qartë në Kontratë.

**Neni 9 Garancia**

**9.1** Periudha e vlefshmërisë së garancisë do të jetë si më poshtë:

**Shtojca 19.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 20**

## Draft i Marrëveshjes Kuadër Ku përcaktohen të gjitha kushtet

**SHËRBIME**

[*Përdorimi i kësaj drafte marrëveshje është i detyrueshëm për të gjithë autoritetet kontraktore që do të përdorin Marrëveshjen Kuadër]*

**Nr . __**

**datë :**

Kjo Marrëveshje është lidhur më [datë] ndërmjet [emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor], këtu e tutje referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe [emri dhe adresa e Kontraktorit] përfaqësuar nga [përfaqësuesi], këtu e më tej referuar si "Kontraktori ".

Kontraktori, përmes ofertës së tij, me datë [data] pajtohet të furnizojë mallrat, siç specifikohet në kushtet e përcaktuara në:
- Këtë Formular;
- Formularin e Deklarimit të Ofertës të paraqitur nga Ofertuesi;
- Specifikimet Teknike;
- Termat e referencës;
- Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Të gjitha këto dokumente janë të bashkangjitura, si pjesë integrale e kësaj marrëveshje.

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i Marrëveshjes Kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dërgimin e shërbimeve të mëposhtme.

[ Përshkrim i përgjithshëm ]

1.2 Marrëveshja Kuadër do të zbatohet duke dërguar ftesa për oferta tek Operatorët Ekonomikë, palë në marrëveshje sipas nevojave të Autoritetit kontraktor.

1.3 Shumat e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin Kontraktor t'i blejë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara.

1.4 Kontraktori nuk do të ketë të drejtë për kompensim dhe nuk do të lejohet të bëjë ndryshime në çmimet për njësi, për shembull nëse Autoriteti Kontraktor vendos të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara të specifikuara dhe / ose nëse Autoriteti Kontraktor vendos të mos blejë cilëndo nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:_______________________________________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për shërbime përshkruhen në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

2.2 Çmimet për njësi do të jenë fikse dhe nuk do të ndryshojnë për porositë e bëra në bazë të kësaj Marrëveshje Kuadër.

**Nënshkrimet dhe datat**

| **Për Kontraktorin** | | **Për Autoritetin Kontraktor** | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

## Shtojca 21.

## Draft Marrëveshja Kuadër Ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

### SHËRBIME

Emri i Autoritetit Kontraktor,

dhe

Emri i Kontraktorit

Bien dakord si më poshtë:

**Të nënshkruajnë Marrëveshjen Kuadër për objektin**: <shëno titullin> me numrin identifikues: <*shëno numrin e prokurimit*>

**Neni 1 Objekti**.

1 Objekti i kësaj marrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat që do të lidhen përmes procesit të Mini – konkurrimit vetëm midis Operatorëve Ekonomik që janë palë në këtë Marrëveshje Kuadër.

1.2 Kjo Marrëveshje Kuadër nuk është një kontratë në vetvete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen, bazuar në të.

1.3 Kontraktori është vetëm një prej palëve të Marrëveshjes Kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti Kontraktor, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë Kontraktuesit një "Ftesë për Ofertë" sa herë që ka nevojë për shërbime.

2.2 Kontraktori është i detyruar të paraqesë një Ofertë sa herë që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 3 Kontratat në zbatimin e Marrëveshjes Kuadër**

1.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkurrimit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkurrimit**

4.1 Procesi i mini-konkurrimit do të zhvillohet me të gjithë operatorët ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër, kurdoherë që ka nevojë për shërbime nga ana e Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do të rihapë konkurrimin në të njëjtat kushte ose kushte të tjera të përcaktuara në Ftesën për Oferta, siç përcaktohet në Dokumentet e Tenderit.

4.3 Sa herë që ka nevojë për shërbime, Autoriteti Kontraktor  përgatit Ftesat për Oferta dhe i dërgon ato te të gjithë Operatorët Ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër. Vlerësimi i Ofertave do të bazohet në kriteret e përcaktuara në Ftesën për Oferta.

**Neni 5      Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër** ___________________________________

**Firmat dhe Data**______________________________________________________________

**Për Kontraktorin** | **Për Autoritetin Kontraktor**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

## SEKSIONI IV

## Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit

**Shtojca 22**: Formulari i Ankesës pranë Autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca 23**: Formulari i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë Autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca 24**: Njoftimi i Kontratës së nënshkruar

**Shtojca 25**: Njoftimi i Kontratës së nënshkruar që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

**Shtojca 26:** Formulari i Anulimit të Procedurës së Prokurimit në përfundim të afateve të ankimimit

**Shtojca 22.**

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatoresh ekonomike)*

________________________________________
Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

________________________________________
Nuis/Nipt

________________________________________
Adresa

| | | |
|---|---|---|
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar / Posta |

| | |
|---|---|
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

________________________________________
E-mail

________________________________________
Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

| | |
|---|---|
| Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. **Numri i referencës së procedurës/Lotit**

*Plotësoni numrin e references se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

________________________________________________________________________________________

2. **Lloji i Procedurës**

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur<br>☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar<br>☐ |
| Procedurë e kufizuar<br>☐ | Procedurë konkurruese me negocim<br>☐ |
| Partneritet për inovacion<br>☐ | Dialog konkurrues<br>☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit<br>☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës<br>☐ |
| Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP<br>☐ | |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

________________________________________________________________________________________

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(*Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

________________________________________________________________________________________

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër

(*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).*

________________________________________________________________________________________

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(*Data (viti/muaji/dita*)

7. Data e publikimit te Njoftimit te Fituesit
(*Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme*)

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

(*Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës*)

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

1.Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. **Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☐

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

*(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)*

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate

☐

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër

☐

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

**3. Rrethanat dhe faktet**
*Përshkruani rrethanat e faktit.*

**4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**
*Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

**5. Kërkesë për ekspertizë të posacme**

| Po | Jo |
| --- | --- |
| ☐ | ☐ |

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*
____________________________________________________________________
____________________________________________________________________

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

____________________________________________________________________
____________________________________________________________________

7. **Lista e informacionit konfidencial**:
____________________________________________________________________

____________________________________________________________________

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik,** në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar**

**Shtojca 23.**

**FORMULARI I PARAQITJES SË ARGUMENTAVE NGA OPERATORËT EKONOMIKË TE INTERESUAR PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

**Paraqitja e argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar drejtuar**:

Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i Operatorit/ëve Ekonomikë/Bashkimit të operatorëve ekonomikë**

______________________________________________

Emri i plotë i Operatorit Ekonomik/Operatorëve Ekonomikë (ju lutem shtypeni)
Nuis/Nipt

______________________________________________

Adresa

______________ ______________ ______________

Qyteti Shteti Kodi Postar / Posta

______________________ ______________________

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

______________________________________________

E-mail

______________________________________________

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për dërgimin e këyre kundërshtimeve (ju lutemi shkruani)

______________________ ______________________

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar Data (viti/muaji/dita)

______________________ ______________________

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

______________________________________________

*Plotësoni numrin e references se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

______________________________________________

**2. Lloji i Procedurës**

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur ☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar ☐ |
| Procedurë e kufizuar ☐ | Procedurë konkurruese me negocim ☐ |
| Partneritet për inovacion ☐ | Dialog konkurrues ☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐ |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

______________________________________________

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

______________________________________________

*Vlera e përllogaritur e kontratës/* Marrëveshjes Kuadër *(shuma në shifra dhe fjalë)*

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

______________________________________________

*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader.*

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

______________________________________________

Data (viti/muaji/dita)

7. Ankesa që po shqyrtohet:

(*emri i Operatorit ekonomik që ka paraqitur ankesë për këtë procedurë prokurimi*)

______________________________

8. Data e Publikimit të Njoftimit të Fituesit

______________________________________________

Data (viti/muaji/dita)

**Seksioni III. Argumentat mbi ankesën e paraqitur nga Operatori/ët ekonomikë**

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

______________________________________________

2. Deklaratë e hollësishme e argumenteve mbi ankesën e paraqitur

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin argumentimet tuaja. Për çfarëdo arsye, specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ketyre srgumenteve. Përmendni seksionet përkatëse të Dokumenteve të Tenderit, nëse është e zbatueshme. Përdorni faqe shtesë nëse është e nevojshme.*

3. Lista e informacionit konfidencial

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

______________________________________________

Dërgojeni formularin e plotësuar të argumentimevemeve tuaja, si dhe të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

**Shënim: Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentat e tyre që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të LPP, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.**

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Operatorit /eve Ekonomikë**

**Shtojca 24.**

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

# Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

**Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor**

## 1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri ______________________________

Adresa ______________________________

Tel/Faks ______________________________

E-mail ______________________________

Ueb-faqe ______________________________

**I.2 Lloji i Autoritetit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Institucion qendror ☐ | Institucion i pavarur ☐ |
| Njësia e Qeverisjes Vendore ☐ | Të tjera ☐ |

1.3 **Procedura e prokurimit për lidhjen e kësaj kontrate është zhvilluar nga::**

| | | |
|---|---|---|
| Autoritet kontraktor që prokuron për nevoja të veta ☐ | Organ Qendror blerës ☐ | Ofruesi Shërbimit: Publik ☐ Privat ☐ |
| I deleguar ☐ | Të tjera ☐ | |

**Seksioni 2. Objekti i Kontratës**

**2.1 Numri i referencës së procedurës / Lotit**

______________________________

**2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Shërbime"**

**2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po ☐ Jo ☐

**Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër**

**Me një Operator Ekonomik** ☐

**Me disa operatorë ekonomik** ☐

**Të gjitha kushtet janë të vendosura** Po ☐ Jo ☐

**2.4 Përshkrimi i shkurtër i kontratës**

2. Fondi limit____________________________________________________________
3. Burimi i financimit ____________________________________________________
4. Objekti i Kontratës ________________________________________

**2. 5 Kohëzgjatja e Kontratës ose afati i përfundimit:**

Kohëzgjatja në **muaj** ☐☐☐ **ose ditë** ☐☐☐☐

ose

Duke nisur ☐☐/☐☐/☐☐☐☐ dhe përfunduar në ☐☐/☐☐/☐☐☐☐

**2.6 Ndarja në LOTE:**

Po ☐ Jo ☐

*Nëse po,* numri i LOTEVE**:** ☐☐

**2.7 Kontrata me nënkontraktim:**

Po ☐ Jo ☐

**Seksioni 3. <u>Procedura</u>**

**3.1 Lloji i procedurës: E hapur e thjeshtuar**

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**A) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □**

Sipas rëndësisë: Çmimi □□ **pikët □**

etj. □□ **pikë**

*ose*

**B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □**

**3.3 Numri i ofertave të paraqitura: □□□**

**Numri i ofertave të rregullta: □□□**

**3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

Po □ Jo □

**3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), kur standardet nuk janë të zbatueshme, aprovimi paraprak merret nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.**

Po □ Jo □

**Seksioni 4**<u>**Informacion rreth Kontratës**</u>

**4.1 Numri i kontratës: ________________________________ Data e kontratës** □□/□□/□□□□

**4.2 Emri dhe adresa e Kontraktorit**

Emri ______________________________________________________________________

Adresa ______________________________________________________________________

Nipti ______________________________________________________________________

Tel/Faks

E-mail ______________________________________________________________________

Ueb-faqe ______________________________________________________________________

4.2.1 **Emri dhe adresa e nënkontraktorit**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Nipti ____________________________________________

Tel/Faks

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe ____________________________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e Kontratës** *(përfshirë shumë, opsione dhe nënkontraktime):*

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha ______________________

Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha ______________________

**4.3.1** Vlera totale e **nënkontraktimit:** ____

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha ______________________

Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha ______________________

**4.4 Informacion Shtesë**

____________________________________________

____________________________________________

Data e dorëzimit të këtij njoftimi □□/□□/□□□□

**Shtojca 25.**

*[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti  Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]*

## Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

### 1. Emri dhe adresa e Autoritetit /Enti Kontraktor

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Faks ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Ueb-faqe ______________________________________________

**2. Lloji i procedurës: ______________________________________________**

**3. Objekti i kontratës ____________________________________**

**4. Numri i referencës së procedurës / Lotit ______________________________________**

**5. Fondi Limit ____________________________________________**

**6. Data e Publikimit në SPE** të Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit _______:

[11]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit *[Data] (Numri)*

**7. Vlera totale përfundimtare e kontratës (***përfshirë Lotet, opsionet dhe nënkontraktimin)*:

Vlera _____________ *(me TVSH)* Monedha ______________________

### 8. Emri dhe adresa e Kontraktorit

Emri

______________________________________________

Adresa

______________________________________________

[11] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtij njoftimi në BNJP*

Numri i NIPT-it
______________________________________________________________

***OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** ☐ ***JO*** ☐

*<u>Nëse po,</u> të jepen dhënat* ______________________________________

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Vlera e nënkontraktimit _______________ *me TVSH* Monedha __________________________

**8. Data e nënshkrimit të kontratës**
______________________________________________________________

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**Shtojca 26.**

## FORMULARI I ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIMIT

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

Emri__________________
Adresa__________________
Tel/Faks__________________
E-mail__________________
Ueb-faqe____________________________________________________________

**2. Lloji i procedurës: Hapur e Thjeshtuar**

**3. Numri i Referencës së procedures/lotit:**

**4. Objekti i Kontratës** __________________________________________________________

**5. Fondi Limit**__________________________________________________________________

**6. Arsyet e Anulimit:**

□*në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;*
□*në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*
□*konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;*
□*për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;*
□*kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në LPP;*
□*kur titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas parashikimeve në nenin 19/4 të LPP.*

**7. Data e publikimit** në SPE të Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit:____

[12]Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Anullimit nga i cili nisin afatet e ankimit [ Nr] [date]

**8.** Ankesa pas Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO □ JO□

[12] *Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtij njoftimi në BNJP*

Nëse Po ( *Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

Në përfundim të afatit për paraqitjen e ankesave ______/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to, procedura e prokurimit me objekt "___________", anullohet.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi

**[Titullari i Autoritetit Kontraktor]**